# Tiguan

## Manuali i përdorimit



## Faleminderit për besimin tuaj

Me këtë Volkswagen ju merrni një automjet me teknologjinë më moderne dhe me shumë pajise komode, të cilat ju me siguri dëshironi në udhëtimet tuaja të përditshme.

**Lexoni dhe kushtoni vëmendje para përdorimit të parë informacionet në këtë manual përdorimi, në mënyrë që ta njihni shpejt dhe në mënyrë të detajuar automjetin si dhe të mund të dalloni rreziqet e mundshme për veten tuaj dhe për të tjerët dhe ti mënjanoni ato.**

Nëse keni pyetje të tjera mbi automjetin tuaj ose nëse mendoni që manuali i bordit nuk është i plotë, drejtohuni te partneri juaj i Volkswagen. Atje pyetjet, sugjerimet dhe kritika janë gjithmonë të mirëpritura.

Ta gëzoni makinën tuaj dhe ju urojmë gjithmonë udhëtim të mbarë.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Ju lutemi respektoni të udhëzime e rëndësishme të sigurisë për përdorimin e sistemeve mbajtëse të fëmijëve në sediljen e pasagjerit para *Ndenjëset e fëmijëve*

## Mbi manualin e përdorimit

Ky manual përdorimi është i vlefshëm për të gjitha variantet dhe modelet e Volkswagen-it tuaj dhe vitin e prodhimit. Manuali i përdorimit përshkruan të gjitha pajisjet dhe modelet, pa i identifikuar ato si pajisje të veçanta pse variante modelesh. Kështu mund të jenë përshkruar pajisje, të cilat automjeti juaj nuk i ka ose të cilat mund të ofrohen vetëm në disa vende. Pajisjen e vërtetë të automjetit tuaj shikojeni te dokumentet e shitjes ose drejtohuni te një oficinë e specializuar e kualifikuar për këtë qëllim. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

Në këtë manual përdorimi është përshkruar një autoveturë.

Në varësi të vendit sipas lejes së qarkullimit të automjetit, modeli i automjetit mund të jetë edhe një automjet tregtar i lehtë.

Të gjitha të dhënat në këtë manual përdorimi përkojnë me statusin e informacionit në momentin kohor të përfundimit të redaktimit. Për shkak të zhvillimit të vazhdueshëm të mëtejshëm të automjetit janë të mundura mospërputhje të mundshme ndërmjet automjetit dhe të dhënave në këtë manual përdorimi. Nga të dhënat, fotografitë dhe përshkrimet e ndryshme nuk mund të ngrihen pretendime.

Përcaktimet e shkurtra të cilat janë paraqitur me ngjyra në disa paragrafë përmbledhin temën përkatëse. Informacione më të detajuara mbi sistemet dhe pajisjet si dhe karakteristikat, përdorimin dhe kufijtë e sistemit të tyre gjenden në paragrafët përkatës.

Për shkak të specifikimeve ligjore si dhe teknike automjeti, në varësi të vendit mund të jetë i pajisur me variante të ndryshme të një manuali përdorimi.

## Manuali i printuar i përdorimit

Manuali i printuar i përdorimit përshkruan gamën e funksioneve të automjetit për përfundimin e redaktimit. Përveç kësaj, plotësimet dhe ndryshimet në manualin e përdorimit mund të përfshihen me një shtesë.

Një Indeks si dhe një Listë shkurtesash të radhitura sipas alfabetit, shpjegojnë shkurtesat profesionale dhe emërtimet, ndihmojnë për orientimin dhe kuptimin e manualit të printuar të përdorimit.

Nëse do ta shisni ose jepni hua automjetin, sigurohuni që dokumentet e printuara të gjendet gjithmonë në automjet. Përveç kësaj Volkswagen këshillon që ta ktheni në gjendjen fillestare sistemin Infotainment, për të fshirë të gjitha të dhënat personale.

# Shpjegime

Në vijim janë shpjeguar formulimet dhe konceptet e manualit të përdorimit për kuptim më të mirë.

## Të dhënat e drejtimit

Drejtimet si majtas, djathtas, para, mbrapa i referohen normalisht drejtimit të udhëtimit, për sa kohë nuk është deklaruar diçka tjetër.

## Përmasat dhe shpejtësitë

Të dhënat mbi miljet në vend të kilometrave ose mph në vend të km/h i referohen kruskoteve specifike sipas vendeve ose sistemeve të Infotainment.

## Figurat

Figurat shërbejnë për orientim dhe duhen kuptuar si ilustrime në parim. Figurat mund të ndryshojnë nga automjeti juaj.

Ky manual përdorimi është përpiluar për automjete me timonin në krahun e majtë. Në rastin e *Automjeteve me timon në krahun e djathtë* elementët e komandimit janë orientuar pjesërisht ndryshe nga ajo që është paraqitur në fotografi ose që është përshkruar në tekst.

## Forma e adresimit

Për lexueshmëri më të mirë do të përdoret forma mashkullore e të shprehurit. Me këtë formë adresohen në mënyrë të njëjtë të gjitha gjinitë. Forma e shkurtuar e të folurit ka arsye redaksionale dhe nuk përmban një vlerësim.

## Konceptet e përdorura dhe kuptimi i tyre:

Baxha me xham
: Koncepti baxha me xham përdoret në mënyrë uniforme për të gjitha variantet e baxhës me rrëshqitje ose baxhës pop-out në varësi të pajisjes.

Ndërmarrje e specializuar
: Ndërmarrjet e specializuara janë ofiçina, në të cilat punon personel i instruktuar ose i trajnuar dhe që janë specializuar, për të kryer punime servisi tek autoveturat. Një ndërmarrje e specializuar mund të jetë si një partner i Volkswagen ashtu edhe një ofiçinë e pavarur.

Partneri i Volkswagen

Partnerët e Volkswagen janë ofiçina, të cilët kanë një marrëdhënie kontraktuale me Volkswagen. Nëpërmjet marrëdhënies kontraktuale janë në dispozicion informacione të tjera dhe përveç kësaj një kanal më direkt komunikimi me prodhuesin.

Shkoni te një ofiçinë e specializuar.

Në disa situata është e nevojshme që ju të shkoni me automjetin te një ofiçinë e specializuar për ta kontrolluar.

Kërkoni ndihmë teknike të specializuar.

Nëse nuk do të ishte e mundur të vazhdohej udhëtimi me automjet, është e nevojshme që automjeti të kontrollohej profesionalisht, direkt në vend. Nëse automjeti mund të vazhdojë udhëtimin pas kontrollit ose duhet rimorkiuar, kjo gjë duhet të vendoset më pas në varësi të situatës.

## Shpjegimi i shenjave

| | |
|---|---|
| 🕮 | Identifikon një referencë mbi një paragraf me informacione dhe këshilla sigurie të rëndësishme ⚠ brenda një kapitulli, i cili duhet të respektohet gjithmonë. |
| ◁ | Shigjeta tregon fundin e një paragrafi. |
| STOP | Simboli identifikon situatat, në ë cilat automjeti duhet të ndalohet sa më shpejt të jetë e mundur. |
| TM | Simboli do të thotë „Trademark“ dhe identifikon një markë të njohur, por që nuk është regjistruar (ende) në mënyrë zyrtare. Mungesa e këtij simboli nuk është garanci që emërtimet lejohen të përdoren lirisht. |
| ® | Simboli identifikon një markë të regjistruar. Mungesa e këtij simboli nuk është garanci që emërtimet lejohen të përdoren lirisht. |
| → ⚠<br>→ ⚠<br>→ ⚠ | Simbolet e këtij lloji i referohen këshillave paralajmëruese brenda të njëjtit paragraf ose në faqen e dhënë, për të tërhequr vëmendjen për rreziqe të mundshme aksidentesh dhe lëndimesh dhe si mund të shmangen ato. |
| → ⓘ | Referencë nga diku tjetër për një dëm të mundshëm material, brenda të njëjtin paragraf ose në faqen e dhënë. |

**⚠ RREZIK**

Tekstet me këtë simbol tërheqin vëmendjen për situata të rrezikshme, të cilat kur shpërfillen shkaktojnë vdekjen ose lëndime të rënda.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Tekstet me këtë simbol tërheqin vëmendjen për situata të rrezikshme, të cilat kur shpërfillen mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndime të rënda.

**⚠ KUJDES**

Tekstet me këtë simbol tërheqin vëmendjen për situata të rrezikshme, të cilat kur shpërfillen mund të shkaktojnë lëndime të lehta ose mesatare.

*UDHËZIM*

Tekstet me këtë simbol tërheqin vëmendjen për situata, të cilat kur shpërfillen mund të shkaktojnë dëmtime të automjetit.

Tekstet me këtë simbol përmbajnë udhëzime për mbrojtjen e mjedisit.

Tekstet me këtë simbol përmbajnë informacione shtesë.

## Pamja nga përpara




**Fig. 1** Përmbledhje e automjetit nga përpara.

1. Dorezat e derës *Dyert*
2. Fenerët e përparmë *Ndriçimi i jashtëm*
3. Sensorët për sistemet e asistencës *Kujdesi për automjetin jashtë*
4. Prapa një mbulimi: Vendosja e një hallke për rimorkim *Montimi ose çmontimi i rimorkios*
5. Prapa emblemës së VW: Sensori radar për sistemet e asistencës *Kujdesi për automjetin jashtë*
6. Leva për hapjen e kapakut të përparmë *Në dhomëzën e motorit*
7. Xhami i përparmë
   - me numrin e identifikimit të automjetit *Të dhënat teknike*
   - me ngrohje të xhamit të përparmë *Ngrohja e xhamit të përparmë*
   - me fshirësen e xhamit të përparmë *Fshirësja e xhamit*
   - me xhamin e shikimit të kamerës për sistemet e asistencës *Kujdesi për automjetin jashtë*
   - me sensorin e dritës-shiut në zonën e pasqyrës së brendshme *Sensori i shiut-dritës*, *Kujdesi për automjetin jashtë*

## Pamja nga prapa




**Fig. 1** Përmbledhje e automjetit nga prapa.

1. Antena e çatisë *Marrësi radio dhe antena*
2. Dritat e vendosura lart të frenave
3. Xhami i pasmë:
   - me sistemin e ngrohjes së xhamit të pasmë *Sistemi i ngrohjes së xhamit të pasmë*
   - me fshirësen e xhamit të pasmë *Fshirësja e xhamit*
4. Fusha:
   - butoni për hapjen e derës së bagazhit *Kapaku i dhomëzës së bagazhit*
   - kamera për sistemet e parkimit *Kamera e pamjes së pasme*, *Kujdesi për automjetin jashtë*
5. Drita e targave *Ndriçimi i jashtëm*
6. Rregullimi rimorkios *Funksioni i rimorkios*
7. Prapa një mbulimi: Vendosja e një hallke për rimorkim *Montimi ose çmontimi i rimorkios*
8. Pas prapakolpit: Sensori radar për sistemet e asistencës *Kujdesi për automjetin jashtë*
9. Sensorët për sistemet e asistencës *Kujdesi për automjetin jashtë*
10. Pikat e vendosjes së krikut *Ndërrimi i rrotës*
11. Dritat e pasme *Ndriçimi i jashtëm*
12. Kapaku i serbatorit *Llojet e karburanteve dhe mbushja e serbatorit*

13 Pasqyrat e jashtme *Pasqyra e jashtme*

— me treguesin e asistentit për ndërrimin e korsisë (Side Assist) *Asistenti i ndërrimit të korsisë (Side Assist)*

— me kamera për pamjen përreth (Area View) *Pamja e mjedisit rrethues*, *Kujdesi për automjetin jashtë*

14 Shinat mbi tavan *Skara e bagazheve mbi çati*

## Dera e shoferit




**Fig. 1** Dera e shoferit (me timon në të majtë): Elementet e komandimit (me timonin djathtas e pasqyruar në anën tjetër).

1. Drita e kontrollit e mbylljes qendrore *Dritat e kontrollit në derën e shoferit*
2. Leva e hapjes së derës
3. Butoni i mbylljes qendrore për mbylljen dhe hapjen e automjetit *Butoni i bllokimit qendror*
4. Butoni për hapjen e derës së bagazhit *Kapaku i dhomëzës së bagazhit*
5. Kutia e mbajtjes me mbajtësen e shisheve për pije
6. Kutia e mbajtjes me hapësirën e ruajtjes për një jelek fluoreshent *Pajimet në raste emergjencash*
7. Butoni për çaktivizimin e butonave të krikut elektrik të xhamave në dyert e pasme *Dritarja*
8. Butonat për përdorimin e krikut elektrik të xhamave të dritareve *Dritarja*
9. Butoni i rrotullueshëm për rregullimet dhe funksionet e pasqyrave të jashtme *Pasqyra e jashtme*
   — me përdorimin për asistentët e manovrimit të rimorkios (Trailer Assist) *Asistenti i manovrimit të rimorkios*

## Ana e shoferit




**Fig. 1** Përmbledhje e anës së shoferit (automjetet me timon në të majtë).




**Fig. 2** Përmbledhje e anës së shoferit (automjetet me timon djathtas).

1. Çelësi i dritave *Ndriçimi gjatë drejtimit të automjetit*
2. Rregullatori për rregullimin e distancës së ndriçimit vetëm për ekranin Head-Up *Rregullimi i gjatësisë së dritave*, *Ekrani i projektuar (Head-up display)*
3. Leva e sinjaleve dhe dritave të gjata *Dritat e sinjalit*, *Dritat e gjata*
   - —me çelësin dhe butonat për sistemet ndihmëse të drejtuesit të mjetit *Sistemet e asistencës së shoferit*
4. Agregatet e nxjerrjes së ajrit *Shpërndarja e ajrit të kondicionerit*
5. Kruskoti *Kruskoti digjital (Pro)*
   - —me dritat paralajmëruese dhe të kontrollit *Simbolet në instrumentin e kombinuar*
6. Kutia e mbajtjes
7. Leva për fshirësen dhe larësen e xhamave *Fshirësja e xhamit*
   - —me butonat për përdorimin e menysë *Kruskoti digjital (Pro)*
8. Elementet e komandimit të timonit multifunksional:
   - —për sistemet e asistencës së shoferit *Sistemet e asistencës së shoferit*
   - —për zgjedhjen e menysë *Kruskoti digjital (Pro)*
   - —për pranimin e thirrjeve telefonike **OK**
   - —për Audio, Navigimi ⏮⏭, *Sistemi i informimit dhe argëtimit*, *Navigimi*
   - —për rregullimin e volumit
   - —për aktivizimin e komandimit me zë (në varësi të pajisjes pa funksion) *Komandimi me zë*
   - —për të kaluar nga menyja aktuale te menyja e mëparshme **VIEW** *Kruskoti digjital (Pro)*
9. Boria
10. Çelësi i kuadrit *Çelësi i kuadrit*
11. Pedalet *Pedalet*
12. Vendi i montimit të jastëkut të ajrit të shoferit *Sistemi i jastëkëve të ajrit*
13. Leva për vendosjen e pozicionit të kolonave drejtuese Timoni
14. Vendi i montimit të jastëkut të ajrit te gjunjët *Sistemi i jastëkëve të ajrit*
15. Kutia e mbajtjes
16. Leva e hapjes së kapakut të përparmë *Në dhomëzën e motorit*

## Konsola e mesit




**Fig. 1** Përmbledhje e pjesës së sipërme të konsolës së mesit.

1. Drita e kontrollit për çaktivizimin e jastëkut ballor të ajrit të pasagjerit përpara OFF *Sistemi i jastëkëve të ajrit*
2. Agregatet e nxjerrjes së ajrit *Shpërndarja e ajrit të kondicionerit*
3. Butoni për ndezjen dhe fikjen e dritave paralajmëruese të rrezikut ⚠ *Për raste emergjence*
4. Sistemi i Infotainment *Sistemi i informimit dhe argëtimit*
5. Butonat për ngrohjen e sediljeve *Ngrohja e ndenjëses*
6. Elementet e komandimit të sistemit të klimës *Ngrohja dhe kondicioneri*

—me ngrohës ndihmës *Ngrohja dhe ftohja ndihmëse*




**Fig. 2** Përmbledhje e pjesës së poshtme të konsolës së mesit (automjetet me timon në të majtë).

---

1. Ndezësi i cigareve ose priza 12 Volt *Priza*
2. Leva:
   - —për kambion me friksion të dyfishtë DSG® *Transmisioni automatik (kombinim)*
   - —për kambio manuale *Kuti shpejtësie*
3. Butonat:
   - —për sistemin Start-Stop *Sistemi Start-Stopp*
   - —për sistemet e asistencës për parkimin dhe manovrimin *Parkimi dhe manovrimi*
   - —për zgjedhjen e profilit të drejtimit *Zgjedhja e profilit të drejtimit*
4. Poshtë një mbulimi: Mbajtësja e pijeve
5. Elementi i komandimit për zgjedhjen e profilit të drejtimit *Zgjedhja e profilit të drejtimit*
6. Butoni për funksionin Auto-Hold *Funksioni i ndalimit automatik*
7. Frenat elektronike të parkimit *Frenat elektronike të parkimit*
8. Butoni për ndezjen dhe fikjen e motorit (Press & Drive) *Ndezja e motorit*
9. Kutia e mbajtjes
   - —me funksionin për karikimin pa kabllo sipas standardit QI *Funksioni i karikimit pa kabëll*
10. Porta të USB *Lidhja e multimedias*

---

## Ana e pasagjerit përpara




**Fig. 1** Ana e pasagjerit përpara (automjetet me timon në të majtë): Përmbledhje e panelit të instrumenteve (për automjetet me timon djathtas vlen e njëjta gjë por në krahun tjetër).




**Fig. 2** Kur dera e pasagjerit përpara është e hapur (automjetet me timon në të majtë): Çelësi në panelin e instrumenteve (për automjetet me timon në të djathtë vlen e njëjta gjë por në krahun tjetër).

1. Kutia e kruskotit:
   - me dorezë hapje
   - me sprucator për nxjerrjen e ajrit për ftohjen e sirtarit në kruskot
   - me manualin e bordit
2. Vendi i instalimit i jastëkut ballor të ajrit i pasagjerit përpara në panelin e instrumenteve *Sistemi i jastëkëve të ajrit*
3. Agregatet e nxjerrjes së ajrit *Shpërndarja e ajrit të kondicionerit*
4. Çelësi për fikjen e jastëkut ballor të ajrit për pasagjerin para *Sistemi i jastëkëve të ajrit*

## Elementët e komandimit në ballin e tavanit

| Simboli | Kuptimi |
|---|---|
|   | Butonat për llambat e brendshme dhe të leximit *Ndriçimi i e brendshëm*. |
|  | Çelësi për baxhën me xham *Tavan prej xhami*. |
|  | Butonat për perden e diellit me mbledhje *Grilë mbrojtëse nga dielli në dritaren e sipërme*. |
|   | Butonat për thirrjen e emergjencës, thirrjen informuese dhe thirrjen në rast avarie *Shërbimi i thirrjes së emergjencës (privat)*. |

## Simbolet në kruskot

Dritat paralajmëruese dhe të kontrollit mund të ndriçojnë të veçuara ose në kombinim me njëra-tjetrën dhe tregojnë paralajmërime, defekte ose funksione të caktuara. Disa drita paralajmëruese dhe të kontrollit [redacted] si i kuadrit dhe duhet të fiken pas njëfarë kohe.

[redacted]ilat ndriçojnë te çelësi i ndriçimit, përshkruhen në kapitullin „Ndriçimi“ *Dritat e*

**⚠ PARALAJMËRIM**

Shpërfillja e dritave paralajmëruese pulsuese dhe e mesazheve me tekst mund të sjellë mbetje në rrugë, aksidente dhe lëndime të rënda deri në vdekje.

- Mos i shpërfillni kurrë dritat e ndezura paralajmëruese dhe mesazhet me tekst.
- Ndalojeni mjetin sa më shpejt të jetë e mundur dhe e sigurt për ta bërë.





Mos e vazhdoni udhëtimin!

Drita paralajmëruese qendrore → *Mesazh paralajmërues me prioritetin 1*



Vendosni rripin e sigurimit → *Kërkesa për lidhjen e rripit*



Forca mbajtëse e frenave elektronike të frenimit shumë e ulët → *Forca mbajtëse e frenave elektronike të parkimit është tepër e ulët*

Frenat elektronike të parkimit e ndezur → *Frenat elektronike të parkimit*





Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Sistemi i frenimit me defekt → *Sistemi i frenimit me defekt*



Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Niveli i lëngut të frenave i ulët → *Niveli i lëngut të frenave*



Merrni kontrollin e automjetit dhe jeni të gatshëm për të frenuar! → *Hyrje për temën*



Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Niveli i vajit të motorit tepër i ulët → *Niveli i vajit të motorit shumë i ulët*



Mos e vazhdoni udhëtimin!

Presioni i motorit të vajit shumë i ulët → *Presioni i vajit të motorit tepër i ulët*



Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Sistemi i lëngut ftohës të elektromotorit me defekt → *Lëngu ftohës i motorit*



Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Sistemi i drejtimit me defekt → *Sistemi i drejtimit me defekt*



Asistenti i daljes nga parkimi ka dalluar një pengesë në pjesën e pasme → *Asistenti i daljes nga parkimi*



Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Furnizimi me energji 12 volt me defekt → *Furnizimi me energji 12 volt*



Paralajmërim për përplasje → *Shkallët e paralajmërimit dhe ndërhyrja e frenimit*



Merr tani kontrollin e drejtimit → *Merr kontrollin e drejtimit menjëherë*



Mos vazhdo më tej udhëtimin!

Kambioja e tejnxehur → *Kambioja e tejnxehur*



Sistemi SCR me defekt → *sistemi SCR me defekt*



Niveli i AdBlue tepër i ulët → *Niveli i mbushjes me AdBlue® tepër i ulët*



Drita paralajmëruese qendrore → *Mesazh paralajmërues me prioritetin 2*



Sistemi i jastëkëve të ajrit ose i tendosësve të rripit të sigurimit me pajisje diagnostikimi i fikur → *Drita e kontrollit*

Sistemi i jastëkëve të ajrit apo tendosësve të rripit të sigurimit me defekt → *Drita e kontrollit*

Kontrolli i funksionit i dritës së kontrollit të jastëkëve të ajrit → *Drita e kontrollit*




Jastëku ballor i ajrit i pasagjerit përpara i çaktivizuar → *Çaktivizimi dhe aktivizimi i jastëkut ballor të ajrit të pasagjerit përpara*




Jastëku ballor i ajrit i pasagjerit përpara i ndezur → *Çaktivizimi dhe aktivizimi i jastëkut ballor të ajrit të pasagjerit përpara*




Shërbimi i thirrjes së emergjencës i kufizuar → *Shërbimi i thirrjes së emergjencës i kufizuar*

Shërbimi i thirrjes së emergjencës me defekt → *Problem në sistemin e thirrjeve të emergjencës*



Frenat elektronike të parkimit me defekt →  */ Frenat elektronike të parkimit me defekt*



Kontrollo ferrotat → *Treguesi i konsumimit të ferrotave të frenave*



Ndriçon: Programi elektronik i stabilizimit (ESC) me defekt → *ESC me defekt*

Pulson: Rregullohet programi elektronik i stabilizimit (ESC) ose sistemi i kontrollit të tërheqjes (ASR) → *Programi elektronik i stabilizimit (ESC)*




ESC Sport është e ndezur → *ESC Sport*

Programi elektronik i stabilizimit (ESC) është i fikur → *ESC Off*

Sistemi i kontrollit të tërheqjes (ASR) është i fikur → *ASR*




Sistemi kundër bllokimit të frenave (ABS) me defekt → *ABS nuk funksionon ose ka defekt*



Sistemi i vajit të motorit me defekt → *ose Sistemi i vajit të motorit me defekt*

Niveli i vajit të motorit tepër i ulët → *Niveli i vajit të motorit tepër i ulët*

Niveli i vajit të motorit tepër i lartë → *Niveli i vajit të motorit tepër i lartë*



Sistemi i vajit të motorit me defekt → *ose Sistemi i vajit të motorit me defekt*



Serbatori i karburantit pothuajse bosh → *Serbatori i karburantit pothuajse bosh*



"Travel Assist" (asistenti i udhëtimit) nuk disponohet → *"Travel Assist" (asistenti i udhëtimit) nuk është i disponueshëm ose nuk funksionon sipas parashikimit*



Mos vazhdoni udhëtimin!

Ujë në naftë → *Ujë në naftë*



Ndriçimi i udhëtimit me defekt → *Ndriçimi i udhëtimit me defekt*



Drita e pasme e mjegullës e ndezur → *Ndezja dhe fikja e dritës së pasme të mjegullës*



Sensori i dritës-shiut me defekt → *Sensori i dritës-shiut ka defekt* , → *Sensori i dritës-shiut ka defekt*



Fshirësja e xhamit me defekt → *Fshirëset e xhamave kanë defekt*



Niveli i ujit për larjen e xhamave shumë i ulët → *Niveli i ujit për larjen e xhamave shumë i ulët*



Sistemi i drejtimit me defekt → *Sistemi i drejtimit me defekt*



Mos e vazhdoni udhëtimin!

Presioni i gomave shumë i ulët → *Presioni i gomave i ulët* , → *Presioni i gomave i ulët*

Mos e vazhdoni udhëtimin!

Sistemi i kontrollit të gomave me defekt → *Defekt i treguesit të kontrollit të gomave* , → *Defekt i sistemit të kontrollit të presionit të gomave*




Front Assist i çaktivizuar → *Përdorimi i Front Assist*



Front Assist fillon → *ose Nisja e asistentit të frenave të emergjencës*



Sistemi i kontrollit të shpejtësisë i prishur → *Sistemi i kontrollit të shpejtësisë ka defekt*



Paralajmërim shpejtësie → *Treguesi i të dhënave të udhëtimit (treguesi multifunksional)*



Rregullatori automatik i distancës (ACC) nuk është në dispozicion → *ACC nuk është në dispozicion*



Emergency Assist kontrollon → *Ngarja me Emergency Assist*

Asistenti i mbajtjes së korsisë (Lane Assist) kontrollon → *Ngarja me asistentët e mbajtjes së korsisë*



Asistenti i mbajtjes së korsisë (Lane Assist) kontrollon → *Ngarja me asistentët e mbajtjes së korsisë*

Emergency Assist kontrollon → *Ngarja me Emergency Assist*



Asistenti për ndërrimin e korsisë (Side Assist) i prishur → *Asistenti për ndërrimin e korsisë i prishur*



Asistenti i daljes nga parkimi frenon → *Asistenti i daljes nga parkimi*




Komandimi i motorit me defekt → *Komandimi i motorit me defekt*



Sistemi i gazeve të shkarkimit me defekt → *Defekti i lidhur me sistemin e gazeve të shkarkimit*



Motori me naftë po ngrohet → *Çelësi i kuadrit* , → *Ndezja e motorit* , → *Sistemi i ngrohjes paraprake ose komandimi i motorit*



Filtri i grimcave i bllokuar me blozë → *Filtri i grimcave i bllokuar me blozë*



Xhirot e motorit të kufizuara → *Xhirot e motorit janë kufizuar*



Furnizimi me energji elektrike 12 volt me defekt → *Furnizimi me energji elektrike 12 volt*



Mekanizmi i transmisionit i prishur → *Friksioni rrëshqet* , → *Kambioja e tejnxehur*



Rregullimi përshtatës i shasisë me defekt → *Defekt i rregullimit përshtatës të shasisë (DCC)*



Transmisioni integral → *Defekt i transmisionit integral*



Tërheqësja e rimorkios e mekanizmit tërheqës nuk është e mbyllur → *Tërheqësja e rimorkios e mekanizmit tërheqës të rimorkios nuk është e mbyllur*



Çelës i automjetit nuk ndodhet në automjet → *Nuk u dallua asnjë çelës i vlefshëm automjeti*



Sistemi SCR me defekt → *sistemi SCR me defekt*



Niveli i mbushjes me AdBlue i ulët → *Niveli i mbushjes me AdBlue® i ulët*



Shkelni pedalin e frenave! → *Elektromotori nuk ndizet* , → *Nisja pengohet nga bllokuesi i levës së marsheve*



Automjeti mbahet në qëndrim → *Funksioni Auto-Hold*



Sinjalet → *Drita e kontrollit të sinjaleve*



Sinjalet e rimorkios → *Drita e kontrollit e sinjaleve të rimorkios*



Shpejtësia e ruajtur, rregullimi aktiv → *Hyrje për temën* , → *Ndezja dhe fikja e ACC*

Kufizuesi i shpejtësisë i ndezur → *Hyrje për temën*



Kontrolli i shpejtësisë i aktivizuar, kontrolli aktiv → *Hyrje për temën*




Kufizuesi i shpejtësisë i ndezur, rregullimi aktiv → *Hyrje për temën*



Asistenti i mbajtjes së korsisë (Lane Assist) aktiv → *Ngarja me asistentët e mbajtjes së korsisë*



Asistenti i mbajtjes së korsisë (Lane Assist) aktiv → *Ngarja me asistentët e mbajtjes së korsisë*



Travel Assist është aktiv → *Hyrje për temën*



Rregullatori automatik i distancës (ACC) kontrollon, nuk është dalluar asnjë automjet që udhëton përpara → *Ndezja dhe fikja e ACC*



Rregullatori automatik i distancës (ACC) kontrollon, është dalluar një automjet që udhëton përpara → *Ndezja dhe fikja e ACC*



Asistenti i udhëtimit në dishezë është aktiv → *Asistenti i udhëtimit në dishezë*



Drita e gjatë ose sinjali → *Ndezja dhe fikja e dritave të gjata*



Asistenti i udhëtimit në dishezë nuk është aktiv → *Asistenti i udhëtimit në dishezë*



Temperatura e jashtme më e ftohtë se +4 °C (+39 °F) → *Treguesit e informacionit të kruskotit dixhital Pro* , → *Treguesit e informacionit të kruskotit analog*



Sistemi Start-Stop aktiv → *Sistemi Start/stop*



Sistemi Start-Stop nuk është i disponueshëm → *Sistemi Start/stop*



Gjendja e ngarjes më ekonomike → *Treguesit e informacionit të kruskotit dixhital Pro* , → *Treguesit e informacionit të kruskotit analog*



Duhet të kryhet servisi → *Treguesi i intervalit të servisit*



Travel Assist është aktiv, rregullatori automatik i distancës aktiv, drejtimi përshtatës i ruajtjes së korsisë pasiv → *Hyrje për temën*



Rregullimi i dritave të gjata aktiv → *Ndezja e rregullimit të dritave të gjata* , → *Ndezja e rregullimit dinamik të dritave të gjata*



Merr kontrollin e drejtimit → *Merr kontrollin e drejtimit*



Front Assist fillon → *ose Nisja e asistentit të frenave të emergjencës*



Paralajmërimi i distancës → *Shkallët e paralajmërimit dhe ndërhyrja e frenimit*



Kontrolli i shpejtësisë i aktivizuar → *Hyrje për temën*



Sistemi i kontrollit të shpejtësisë i prishur → *Sistemi i kontrollit të shpejtësisë i prishur*



Rregullatori automatik i distancës (ACC) kontrollon, nuk është dalluar asnjë automjet që udhëton përpara → *Ndezja dhe fikja e ACC*



Rregullatori automatik i distancës (ACC) kontrollon, është dalluar një automjet që udhëton përpara → *Ndezja dhe fikja e ACC*





Kufizuesi i shpejtësisë i ndezur, rregullimi aktiv → *Hyrje për temën*



Profili i drejtimit Offroad → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Profili i drejtimit Eco → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Profili i drejtimit Comfort → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Rregullimi sipas itinerarit → *Drejtimi me kontrollin parashikues të shpejtësisë*



Profili i drejtimit Normal → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Profili i drejtimit Individual → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Profili i drejtimit Sport → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Profili i drejtimit Snow → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Profili i drejtimit Offroad Individual → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Telefoni celular i lidhur nëpërmjet Bluetooth® → *Treguesit e informacionit të kruskotit dixhital Pro* , → *Treguesit e informacionit të kruskotit analog*



Profili i drejtimit Race → *Karakteristikat dhe profilet e drejtimit*



Gjendja e karikimit të baterisë së telefonit celular → *Treguesit e informacionit të kruskotit dixhital Pro* , → *Treguesit e informacionit të kruskotit analog*



Këshillë mbi informacionet në manualin e përdorimit → *Këshillë për informacione në manualin e përdorimit*




Kontrolli i shpejtësisë për shkak të një kufizimi të shpejtësisë → *Drejtimi me kontrollin parashikues të shpejtësisë*



Sistemi SCR me defekt → *sistemi SCR me defekt*



Niveli i mbushjes me AdBlue i ulët → *Niveli i mbushjes me AdBlue® i ulët*

# Tekstet paralajmëruese dhe informuese

Kur ndizet kuadri ose gjatë udhëtimit kontrollohen disa funksione në automjet dhe disa komponentë të automjetit për sa i përket gjendjes së tyre. Defektet e funksionit tregohen me simbole paralajmërues në ngjyrë të verdhë me mesazhe me tekst në ekranin e kruskotit dhe mund të sinjalizohen edhe në mënyrë akustike. Në varësi të modelit të kruskotit paraqitja e teksteve dhe simboleve mund të ndryshojë.

Përveç të tjerave defektet aktuale të funksioneve mund të thirren manualisht. Për këtë, hapni menynë **Vehicle status (Statusi i automjetit)** ose **Vehicle (Automjeti)** *Menuja e cilësimeve të automjetit*.

## Mesazh paralajmërues me prioritetin 1

Drita paralajmëruese qendrore e kuqe pulson dhe ndriçon pjesërisht bashkë me tonet paralajmëruese ose simbolet shtesë. **Mos vazhdo më tej udhëtimin!** Ekziston një rrezik. Kontrolloni funksionin me defekt. Kërkoni menjëherë ndihmë teknike të specializuar.

## Mesazh paralajmërues me prioritetin 2

Drita paralajmëruese qendrore e verdhë pulson dhe ndriçon pjesërisht bashkë me tonet paralajmëruese ose simbolet shtesë. Funksionimet e gabuara ose mungesa e substancave të lëngshme punës mund të shkaktojnë dëmtime të automjetit dhe dështimin e automjetit. Funksioni me defekt duhet të kontrollohet sa më shpejt. Shkoni menjëherë te një ofiçinë e specializuar e kualifikuar për këtë qëllim dhe kontrolloni sistemin. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

## Këshillë për informacione në manualin e përdorimit

Në manualin e përdorimit gjeni këshilla të tjera mbi mesazhin paralajmërues në fjalë.

## Teksti informues

Informacione mbi procese të ndryshme në automjet.

Nëse ekzistojnë disa mesazhe paralajmërues, simbolet shfaqen njëri pas tjetrit për disa sekonda. Simbolet shfaqen për aq kohë, deri sa të jetë gjetur dhe riparuar arsyeja.

Nëse gjatë ndezjes së kuadrit tregohen mesazhet paralajmërues për defektet e funksionit, mund të ndodhë që cilësimet ose tregimi i informacioneve të mos kryhet siç është përshkruar. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni një ofiçinë të specializuar dhe kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

Informacione për shoferin

# Hyrje për kruskotin

Automjeti mund të jetë i pajisur me një kruskot analog ose dixhital. Kruskoti tregon informacionet bazë, p.sh. shpejtësinë.

Për më tepër, në varësi të pajimit janë në dispozicion ndër të tjera funksionet e mëposhtme:

—Menytë e ndryshme, p.sh. për sistemet e asistencës së drejtuesit të mjetit.

—Treguesit e statusit për sistemet e asistencës së drejtuesit të mjetit.

—Njoftimet e ekranit.

—Dritat paralajmëruese dhe të kontrollit.

—Informacionet për konsumin e autonomisë.

Në menytë mund të përshtaten individualisht përmbajtjet dhe të kryhen cilësimet.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Nëse drejtuesi i mjetit shpërqendrohet gjatë udhëtimit, mund të shkaktohen aksidente dhe lëndime të rënda.

- Mos e përdorni kurrë kruskotin gjatë udhëtimit.
- Kryejini të gjitha konfigurimet në kruskot dhe në sistemin Infotainment vetëm kur automjeti të jetë i ndaluar.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Nëse paraqitet një gabim serioz në kruskot, ekrani mund të fiket. Për më tepër, mund të ndriçojë drita e kontrollit ⚠.

- Parkoni automjetin në mënyrë të sigurt.
- Merrni ndihmë të specializuar.

ℹ Pas ndezjes së elektromotorit me baterinë e shkarkuar ose të ndërruar 12 Volt të automjetit ose pas ndihmës së dhënë në ndezje, mund të jenë ndryshuar ose fshirë cilësimet e sistemit, p.sh. cilësimet personale të komoditetit dhe programimet. Kontrolloni cilësimet dhe korrigjojini, pasi bateria 12 volt e automjetit të jetë karikuar përsëri mjaftueshëm.

## Pamja e përgjithshme e kruskotit dixhital Pro

Digital Cockpit Pro është një kruskot dixhital me një ekran TFT me ngjyra me rezolucion të lartë. Nëpërmjet zgjedhjes së profileve të ndryshme të informacionit mund të paraqiten gjithashtu tregues të tjerë për instrumentet klasike të rrumbullakëta, p.sh. treguesi matës i numrit të xhirove. Në vijim, për Digital Cockpit Pro përdoret emërtimi „kruskoti dixhital Pro“.




**Fig. 1** Kruskoti dixhital Pro panelin e instrumenteve (Paraqitje ilustruese).

1. Treguesi matës i numrit të xhirove (Xhirot x 1000 në minutë të motorit në punë).
2. Marshi aktual i vendosur ose pozicioni i levës së marsheve *Drejtimi i automjetit*.
3. Treguesit në ekran.
4. Shpejtësimatësi (Matësi i shpejtësisë).
5. Treguesi dixhital i shpejtësisë.

## Përdorimi i kruskotit dixhital Pro




**Fig. 1** Ana e djathtë e timonit multifunksional: Përdorimi i kruskotit dixhital Pro (varianti 1).




**Fig. 2** Ana e djathtë e timonit multifunksional: Përdorimi i kruskotit dixhital Pro (varianti 2).




**Fig. 3** Te kolona e timonit djathtas: Butonat te leva e fshirëseve të xhamave.

Tek automjetet me timon multifunksional nuk ka butona te leva e fshirëseve të xhamave. Atëherë kruskoti dixhital Pro përdoret vetëm nëpërmjet butonave në timonin multifunksional. Funksionet e butonave në timonin multifunksional janë të varura nga pajimi.

*Automjetet me timon multifunksional:* Për sa kohë tregohet një mesazh paralajmërues i prioritetit 1, nuk mund të thirren meny *Tekstet paralajmëruese dhe informuese*. Disa mesazhe paralajmëruese mund të konfirmohen dhe hiqen me butonin **OK** në timonin multifunksional → *fig. 1* , → *fig. 2* .

*Automjetet pa timon multifunksional:* Për sa kohë tregohet një mesazh paralajmërues i prioritetit 1, nuk mund të thirren meny *Tekstet paralajmëruese dhe informuese*. Disa mesazhe paralajmëruese mund të konfirmohen dhe hiqen me butonin OK/RESET → *fig. 3* (1) .

## Zgjedhja e menysë ose tregimi i informacionit

Automjetet me timon multifunksional:

1. Ndizni kuadrin.
2. Nëse tregohet një mesazh ose skica e automjetit, shtypni butonin OK, nëse është e nevojshme disa herë.
3. Për tregimin e një menyje dhe për të shfletuar përmes menysë, shtypni butonin ⧉ ose ⧉.
4. Për të thirrur menynë e treguar ose tregimin e informacionit, shtypni butonin OK ose prisni, deri sa menyja ose treguesi i informacionit të hapet në mënyrë të pavarur pas disa sekondave.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Ndizni kuadrin.
2. Nëse tregohet një mesazh ose skica e automjetit, shtypni butonin OK/RESET → *fig. 3* (1) , nëse është e nevojshme disa herë.
3. Për të arritur te zgjedhja e menysë ose për tu kthyer nga një meny ose një tregim informacioni te përzgjedhja e menyve, mbani të shtypur bilancierin → *fig. 3* (2) .
4. Për të shfletuar ndërmjet menyve, shtypni bilancierin lart dhe poshtë.
5. Për të thirrur menynë e treguar ose tregimin e informacionit, shtypni butonin OK/RESET → *fig. 3* (1) ose prisni, deri sa menyja ose treguesi i informacionit të hapet në mënyrë të pavarur pas disa sekondave.

## Kryerje e konfigurimeve te menytë

Automjetet me timon multifunksional:

1. Në menynë e treguar shtypni butonin me shigjetë △ ose ▽, deri sa të arrihet pika e dëshiruar e menysë.

   Shënimi tregohet me anën e një kornize.
2. Për të kryer ndryshimet e dëshiruara, shtypni butonin OK.

   Një grep ☑ identifikon që funksioni përkatës është i ndezur.
3. Për tu kthyer te përzgjedhja e menysë, shtypni butonin ⧉ ose ⧉.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Në menynë e treguar shtypni lart ose poshtë bilancierin → *fig. 3* (2) , deri sa të jetë shënuar pika e dëshiruar e menysë.

   Shënimi tregohet me anën e një kornize.
2. Për të kryer ndryshimet e dëshiruara, shtypni butonin OK/RESET → *fig. 3* (1) .

   Një grep ☑ identifikon që funksioni përkatës është i ndezur.
3. Zgjidhni pikën e menysë **Back (Kthehu)** ose mbani të shtypur bilancierin → *fig. 3* (2) .

## Butoni VIEW në timonin multifunksional

Me butonin VIEW mund të bëhet kalimi ndërmjet paraqitjes klasike të instrumenteve të rrumbullakët, skenës së madhe pa profile informacioni dhe pamjes së zgjeruar me profile të theksuara informuese. Paraqitja klasike tregon djathtas dhe majtas instrumentet e mëdhenj rrumbullak dhe në qendër profilin e përzgjedhur të informacionit.

1. Për të zgjedhur nga lista profilet e vendosura paraprakisht të informacionit, mbani të shtypur butonin VIEW:

Klasik
: Pamja pa profile informacioni.

Automatik
: Profilet e informacionit i përshtaten profilit të zgjedhur të drejtimit. Vetëm tek automjetet me zgjedhje të profilit të drejtimit.

Kërkesa për ruajtje 1
: Përzgjedhja individuale e profileve të informacionit.

Kërkesa për ruajtje 2
: Përzgjedhja individuale e profileve të informacionit.

Kërkesa për ruajtje 3
: Vetëm tek automjetet me sistem navigimi të montuar në fabrikë.

## Harta e navigimit në kruskotin dixhital Pro

Në varësi të pajimit, kruskoti dixhital Pro mund të paraqesë një hartë të detajuar të navigimit.

Harta e navigimit mund të paraqitet në tre madhësi. Në rastin e paraqitjes së hartës më të madhe, harta e navigimit shfaqet mbi të gjithë gjerësinë e ekranit. Për të vendosur madhësinë e dëshiruar të hartave, veproni si më poshtë:

1. Zgjidhni pikën e menysë **Navigation (Navigimi)**.
2. Për të kaluar midis madhësive të hartave, shtypni butonin VIEW në timonin multifunksional.
3. Për ta zmadhuar brenda dhe jashtë, shtypni butonin shigjetë △ ose ▽ në timonin multifunksional.
4. Për të ndryshuar madhësinë në mënyrë automatike, gjatë zmadhimit manual shtypni butonin OK në timonin multifunksional.

Në varësi të pajimit, navigimi paraqitet në dy ekrane ose vetëm në një ekran. Harta e navigimit mund të shfaqet në kruskotin dixhital Pro në sistemin Infotainment ose vetëm në sistemin Infotainment. Nëse harta e navigimit paraqitet në sistemin Infotainment, atëherë në kruskotin dixhital janë shfaqur vetëm shigjetat e navigimit.

Nëse gjatë ndezjes së kuadrit tregohen mesazhet paralajmërues për defektet e funksionit, mund të ndodhë që cilësimet ose tregimi i informacioneve të mos kryhet siç është përshkruar. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni një oficinë të specializuar dhe kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

**PARALAJMËRIM**

Nëse drejtuesi i mjetit shpërqendrohet gjatë udhëtimit, mund të shkaktohen aksidente dhe lëndime të rënda.

- Mos e përdorni kurrë kruskotin dixhital Pro gjatë udhëtimit.
- Kryejini të gjitha konfigurimet në kruskotin dixhital Pro dhe në sistemin e Infotainment vetëm kur automjeti të jetë i ndaluar.

**Treguesit e informacionit të kruskotit dixhital Pro**

## Profilet e informacionit

Nëpërmjet pikës së menysë **Digital Cockpit** në cilësimet e automjetit të sistemit të Infotainment mund të zgjidhen profile të ndryshme me tema specifike të informacionit *Menuja e cilësimeve të automjetit*. Në varësi të profilit të zgjedhur të informacionit, kruskoti dixhital Pro tregon informacionet shtesë në mes të instrumenteve të rrumbullakëta ose instrumentet e rrumbullakëta shuhen dhe informacionet shtesë shfaqen në të gjithë gjerësinë e ekranit. Janë të zgjedhshme profilet e mëposhtme të informacionit:

— Audio. Treguesi dixhital i ridhënies aktuale audio.
— Përshpejtimi. Paraqitja grafike e treguesit të përshpejtimit gjatësor dhe tërthor.
— Asistentët e udhëtimit. Paraqitja grafike e sistemeve të ndryshme të asistencës së udhëtimit *Sistemet e asistencës së shoferit*.
— Itinerari. Treguesi i itinerarit të përshkuar.
— Treguesi i marshit. Treguesi i marshit aktual ose i nivelit të zgjedhur të udhëtimit.
— Shpejtësia. Treguesi i shpejtësisë.
— Lartësia. Treguesi i lartësisë aktuale mbi nivelin e detit.
— Busulla. Treguesi dixhital i busullës.
— Navigimi. Paraqitja grafike e navigimit me shigjetë.
— Autonomia. Treguesi i autonomisë.
— Konsumi. Paraqitja grafike e konsumit aktual dhe treguesi dixhital i konsumit mesatar.
— Identifikimi i shenjave të qarkullimit. Paraqitja e shenjave të dallueshme të qarkullimit.
— Informacionet e mbërritjes në destinacion. Treguesi i kohës së mbetur të udhëtimit, largësia për te vendi i destinacionit dhe koha e parashikuar e mbërritjes.

Në varësi të pajimit, numri dhe shtrirja e profileve të zgjedhshme të informacionit mund të ndryshojnë.

## Treguesit e mundshëm në ekran në kruskotin dixhital Pro

Në kruskotin dixhital Pro mund të shfaqen informacione të ndryshme në varësi të pajisjes së automjetit:

— Treguesi i temperaturës së jashtme.
— Shenjat e njohura të qarkullimit për identifikimin e shenjave të qarkullimit.
— Sistemet e asistencës së shoferit.
— Treguesi i të dhënave të udhëtimit dhe menytë për cilësimet e ndryshme.
— Rekomandimi për marshin *Rekomandimi i marshit*.
— Paralajmërimet e shpejtësisë.
— Paralajmërimi i shpejtësisë për gomat e dimrit.
— Dyert, kofano dhe dera e bagazhit të hapura.
— Udhëzimet e sistemit Infotainment dhe të navigimit.
— Treguesit e kilometrave.

—Treguesi i busullës.

—Aktivizimi i ventilatorit ftohës.

—Shkronjat identifikuese të motorit (MKB).

—Personalizimi: Përshëndetja dhe zgjedhja e përdoruesit *Personalizimi*.

—Treguesi i intervalit të servisit.

—Treguesi i statusit të sistemit Start-Stop *Sistemi Start-Stopp*.

—Udhëzimet e telefonit.

—Koha.

—Pozicioni i levës së marsheve.

—Tekstet e paralajmërimit dhe informacionit.

—Dritat paralajmëruese dhe të kontrollit *Simbolet në instrumentin e kombinuar*.

—Në varësi të pajimit: Gjendja e ngarjes më ekonomike eco. Treguesi i statusit të menaxhimit aktiv të cilindrave (ACT) *Mënyrat ekonomike të drejtimit të automjetit*.

## Treguesi i temperaturës së jashtme

Në rastin kur temperatura e jashtme është më e ftohtë se rreth +4 °C (+39 °F) në treguesin për temperaturën e jashtme shfaqet gjithashtu një simbol me kristal akulli ❄. Ky simbol ndriçon derisa temperatura e jashtme të rritet mbi +6 °C (+43 °F).

Në situatat e mëposhtme temperatura e shfaqur nëpërmjet ngrohtësisë rrezatuese të elektromotorit mund të jetë më e lartë sesa temperatura aktuale e jashtme:

—Në rastin kur automjeti ka ndaluar.

—Kur ngrohësi ndihmës është në punë.

—Në rastin e shpejtësisë shumë të ulët të ngarjes.

Zona e matjes është nga -45 °C (-49 °F) deri +76 °C (+169 °F).

**⚠ PARALAJMËRIM**

Rrugët dhe urat mund të jenë të ngrira nga temperaturat e jashtme sipër pikës së ngrirjes. Simboli me kristalin e akullit ❄ i referohet një rreziku të mundshëm për rrëshqitje.
Rrëshqitja nga akulli mund të ndodhë edhe në rastin e temperaturave të jashtme mbi +4 °C (+39 °F), edhe nëse nuk shfaqet simboli me kristalin e akullit ❄.

- Mos besoni kurrë vetëm në treguesin e temperaturës së jashtme!

## Rekomandimi për marshin

Në kruskotin dixhital mund të shfaqet gjatë ngarjes një rekomandim për zgjedhjen e një marshi për kursimin e karburantit *Rekomandimi i marshit*.

## Dyert, kofano dhe dera e bagazhit të hapura

Pas hapjes së automjetit dhe gjatë ngarjes, në kruskotin dixhital tregohen dyert e hapura, si dhe kofano e hapur ose dera e bagazhit e hapur dhe në këtë rast sinjalizohet gjithashtu edhe në mënyrë akustike.

## Paralajmërimi i shpejtësisë për gomat e dimrit

Një tejkalim i shpejtësisë maksimale të vendosur tregohet në kruskotin dixhital.

Cilësimet për paralajmërimin e shpejtësisë mund të kryhen në cilësimet e automjetit në sistemin Infotainment *Goma dimërore*.

## Treguesi i busullës

Nëse kuadri është i ndezur, atëherë ekrani i kruskotit, në varësi të pajimit, tregon anën aktuale të horizontit në formën e një shkurtimi, p.sh. VP për veriperëndim.

Nëse sistemi i Infotainment është i aktivizuar dhe nuk është aktiv asnjë udhëzues i destinacionit, atëherë është e disponueshme paraqitja grafike shtesë e busullës.

## Treguesit e kilometrave

Numëruesi i kilometrave në total regjistron të gjithë itinerarin e përshkuar të automjetit.

Numëruesi i kilometrazhit **trip (udhëtimi)** tregon kilometrat që janë përshkuar pas rivendosjes së fundit të numëruesit të kilometrazhit.

1. Rivendosni numëruesin e kilometrazhit nëpërmjet sistemit Infotainment ose nëpërmjet menysë së servisit *Menuja e shërbimit*.

## Aktivizimi i ventilatorit ftohës

Ky tregues shfaqet pas fikjes së kuadrit, nëse ventilatori ftohës është duke punuar me fikje të vonuar.

Një kohë e aktivizimit të ventilatorit ftohës mund të jetë e kushtëzuar nga:

— Ritrajtimi i gazeve, p.sh. në rastin e rigjenerimit të filtrit të grimcave.

— Ftohësi i frenave aktive pas nisjes tatëpjetë.

— Shpërndarja e nxehtësisë së motorit pas ngarkesave të mëdha, p.sh. në rastin e tërheqjes së rimorkios.

## Shkronjat identifikuese të motorit (MKB)

1. Hapni menynë e servisit *Menuja e shërbimit*.
2. Zgjidhni pikën e menysë **Engine code (Germa identifikuese e motorit)**.

## Udhëzimet e telefonit

Nëse një telefon celular është i lidhur nëpërmjet Bluetooth, atëherë në kruskotin dixhital shfaqet simboli Bluetooth .

Për më tepër, simboli tregon  gjendjen e karikimit të baterisë së telefonit celular.

## Pozicioni i levës së marsheve

Pozicioni i vendosur i levës së marsheve tregohet si anash levës së marsheve, ashtu edhe në kruskotin dixhital.

Në pozicionin D/S të levës së marsheve, si dhe tek Tiptronic, në kruskotin dixhital shfaqet marshi përkatës, sipas rastit *Transmisioni automatik (kombinim)*.

## Gjendja e ngarjes më ekonomike

Gjatë ngarjes në kruskotit dixhital tregohet nëse automjeti është në një gjendje të ngarjes ekonomike.

Disa cilësime mund të ruhen te llogaritë e përdoruesve të personalizimit dhe për këtë arsye mund të ndryshojnë në mënyrë automatike kur ndryshohet llogaria e përdoruesit *Personalizimi*.

Një oficinë e specializuar e kualifikuar për këtë qëllim mund të programojë ose ndryshojë funksione të tjera në varësi të pajisjes së automjetit. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

Ka kruskot të ndryshëm, prandaj versionet dhe treguesit në ekran mund të ndryshojnë. Në rastin e ekranit pa tregues të teksteve paralajmëruese ose informuese, defektet shfaqen vetëm nëpërmjet dritave të kontrollit.

Disa tregues në kruskotin dixhital mund të zbehen nëpërmjet ngjarjeve të shfaqura papritur, p.sh. telefonatat hyrëse.

Në varësi të pajimit, disa cilësime dhe tregues mund të bëhen edhe në sistemin Infotainment.

## Përmbledhje e kruskotit analog




**Fig. 1** Kruskoti analog në panelin e instrumenteve.

1. Treguesi matës i numrit të xhirove (Xhirot x 1000 në minutë të motorit në punë).
2. Treguesi i temperaturës së lëngut ftohës të motorit.
3. Treguesi i ekranit *Kruskoti digjital (Pro)* *Treguesi i të dhënave të automjetit (treguesi shumëfunksional)*.
4. Butoni i rivendosjes, vendosjes dhe treguesit.
5. Shpejtësimatësi (Matësi i shpejtësisë).
6. Treguesi i rezervës së karburantit.

## Përdorimi i kruskotit analog




**Fig. 1** Ana e djathtë e timonit multifunksional: Përdorimi i kruskotit analog (varianti 1).




**Fig. 2** Ana e djathtë e timonit multifunksional: Përdorimi i kruskotit analog (varianti 2).




**Fig. 3** Te kolona e timonit djathtas: Butonat te leva e fshirëseve të xhamave.

*Automjetet me timon multifunksional:*

Për sa kohë tregohet një mesazh paralajmërues i prioritetit 1, nuk mund të thirren meny *Tekstet paralajmëruese dhe informuese*. Disa mesazhe paralajmëruese mund të konfirmohen dhe hiqen me butonin OK → *fig. 1* , → *fig. 2* në timonin multifunksional.

*Automjetet pa timon multifunksional:*

Për sa kohë tregohet një mesazh paralajmërues i prioritetit 1, nuk mund të thirren meny *Tekstet paralajmëruese dhe informuese*. Disa mesazhe paralajmëruese mund të konfirmohen dhe hiqen me butonin → *fig. 3* *1* .

## Zgjedhja e menysë ose tregimi i informacionit

Automjetet me timon multifunksional:

1. Ndizni kuadrin.
2. Nëse tregohet një mesazh ose skica e automjetit, shtypni butonin OK, nëse është e nevojshme disa herë.
3. Për tregimin e një menyje dhe për të shfletuar përmes menysë, shtypni butonin ◂ ose ▸.
4. Për të thirrur menynë e treguar ose tregimin e informacionit, shtypni butonin OK ose prisni, deri sa menyja ose treguesi i informacionit të hapet në mënyrë të pavarur pas disa sekondave.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Ndizni kuadrin.
2. Nëse tregohet një mesazh ose skica e automjetit, shtypni butonin OK/RESET → *fig. 3* (1), nëse është e nevojshme disa herë te leva e fshirëses së xhamave.
3. Për tregimin e menysë *Treguesi i të dhënave të automjetit (treguesi shumëfunksional)* ose për t'u kthyer nga një meny ose një tregim informacioni te përzgjedhja e menyve, mbani të shtypur bilancierin TRIP → *fig. 3* (2) te leva e fshirëseve të xhamave.
4. Për të shfletuar ndërmjet menyve, shtypni bilancierin TRIP → *fig. 3* (2) lart dhe poshtë te leva e fshirëseve të xhamave.
5. Për të thirrur menynë e treguar ose tregimin e informacionit, shtypni butonin OK/RESET → *fig. 3* (1) ose prisni, deri sa menyja ose treguesi i informacionit të hapet në mënyrë të pavarur pas disa sekondave.

## Kryerje e konfigurimeve te menytë

Automjetet me timon multifunksional:

1. Në menynë e treguar shtypni butonat me shigjetat △ dhe ▽, deri sa të arrihet pika e dëshiruar e menysë.

   Shënimi tregohet me anën e një kornize.
2. Konfirmoni zgjedhjen me butonin OK.

   Një grep ☑ identifikon që funksioni përkatës është i ndezur.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Në menynë e treguar shtypni lart ose poshtë bilancierin TRIP → *fig. 3* (2) te leva e fshirëses së xhamave, deri sa të jetë shënuar pika e dëshiruar e menysë.

   Shënimi tregohet me anën e një kornize.
2. Për të kryer ndryshimet e dëshiruara, shtypni butonin OK/RESET → *fig. 3* (1) te leva e fshirëseve së xhamave.

   Një grep ☑ identifikon që funksioni përkatës është i ndezur.

## Kthimi te përzgjedhja e menysë

Automjetet me timon multifunksional:

1. Shtypni butonin ◂ ose ▸.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Zgjidhni pikën e menysë **Back (Kthehu)**.

## Butoni VIEW në timonin multifunksional

*Automjetet me timon multifunksional:*

Me butonin VIEW mund të kalohet ndërmjet pamjeve të ndryshme në zonën e tregimit.

## Treguesit e kilometrave

Numëruesi i kilometrave në total regjistron të gjithë itinerarin e përshkuar të automjetit.

Numëruesi i kilometrazhit (**trip**) tregon kilometrat që janë përshkuar pas rivendosjes së fundit të numëruesit të kilometrazhit.

1. Për të rivendosur në 0 numëruesin e kilometrazhit, shtypni shkurtimisht butonin 0.0 në kruskotin analog.

## Shkronjat identifikuese të motorit (MKB)

1. Ndizni kuadrin, por motori nuk duhet ndezur.
2. Për të treguar germat identifikuese të motorit mbani shtypur për rreth 15 sekonda butonin 0.0 në kruskot.

Nëse gjatë ndezjes së kuadrit tregohen mesazhet paralajmërues për defektet e funksionit, mund të ndodhë që cilësimet ose tregimi i informacioneve të mos kryhet siç është përshkruar. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni një ofiçinë të specializuar dhe kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

**PARALAJMËRIM**

Nëse drejtuesi i mjetit shpërqendrohet gjatë udhëtimit, mund të shkaktohen aksidente dhe lëndime të rënda.

- Mos e përdorni kurrë kruskotin analog gjatë udhëtimit.
- Udhëtoni gjithmonë me kujdes dhe me përgjegjësi.

# Treguesit e informacionit të kruskotit analog

Në kruskotin analog mund të shfaqen informacione të ndryshme në varësi të pajisjes së automjetit:

—Treguesi i temperaturës së jashtme.

—Shenjat e njohura të qarkullimit për identifikimin e shenjave të qarkullimit.

—Sistemet e asistencës së shoferit.

—Treguesi i të dhënave të udhëtimit dhe menytë për cilësimet e ndryshme.

—Rekomandimi për marshin *Rekomandimi i marshit*.

—Paralajmërimet e shpejtësisë.

—Paralajmërimi i shpejtësisë për gomat e dimrit.

—Dyert, kofano dhe dera e bagazhit të hapura.

—Udhëzimet e sistemit Infotainment dhe të navigimit.

—Treguesit e kilometrave.

—Treguesi i busullës.

—Aktivizimi i ventilatorit ftohës.

—Shkronjat identifikuese të motorit (MKB).

—Personalizimi: Përshëndetja dhe zgjedhja e përdoruesit *Personalizimi*.

—Treguesi i intervalit të servisit.

—Treguesi i statusit të sistemit Start-Stop *Sistemi Start-Stopp*.

—Udhëzimet e telefonit.

—Koha.

—Në varësi të pajimit: Gjendja e ngarjes më ekonomike eco. Treguesi i statusit të menaxhimit aktiv të cilindrave (ACT) *Mënyrat ekonomike të drejtimit të automjetit*.

—Pozicioni i levës së marsheve.

—Tekstet e paralajmërimit dhe informacionit.

—Dritat paralajmëruese dhe të kontrollit *Simbolet në instrumentin e kombinuar*.

Një oficinë e specializuar e kualifikuar për këtë qëllim mund të programojë ose ndryshojë funksione të tjera në varësi të pajisjes së automjetit. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

## Treguesi i temperaturës së jashtme

Në rastin kur temperatura e jashtme është më e ftohtë se rreth +4 °C (+39 °F) në treguesin për temperaturën e jashtme shfaqet gjithashtu një simbol me kristal akulli ❄. Ky simbol ndriçon derisa temperatura e jashtme të rritet mbi +6 °C (+43 °F).

Në situatat e mëposhtme temperatura e shfaqur nëpërmjet ngrohtësisë rrezatuese të elektromotorit mund të jetë më e lartë sesa temperatura aktuale e jashtme:

—Në rastin kur automjeti ka ndaluar.

—Kur ngrohësi ndihmës është në punë.

—Në rastin e shpejtësisë shumë të ulët të ngarjes.

Zona e matjes është nga -45 °C (-49 °F) deri +76 °C (+169 °F).

**⚠ PARALAJMËRIM**

Rrugët dhe urat mund të jenë të ngrira nga temperaturat e jashtme sipër pikës së ngrirjes.
Simboli me kristalin e akullit ❄ i referohet një rreziku të mundshëm për rrëshqitje.
Rrëshqitja nga akulli mund të ndodhë edhe në rastin e temperaturave të jashtme mbi +4 °C (+39 °F), edhe nëse nuk shfaqet simboli me kristalin e akullit ❄.

- Mos besoni kurrë vetëm në treguesin e temperaturës së jashtme!

## Rekomandimi për marshin

Në kruskotin analog mund të shfaqet gjatë ngarjes një rekomandim për zgjedhjen e një marshi për kursimin e karburantit *Rekomandimi i marshit*.

## Dyert, kofano dhe dera e bagazhit të hapura

Pas hapjes së automjetit dhe gjatë ngarjes, në kruskotin analog tregohen dyert e hapura, si dhe kofano e hapur ose dera e bagazhit e hapur dhe në këtë rast sinjalizohet gjithashtu edhe në mënyrë akustike.

## Paralajmërimi i shpejtësisë për gomat e dimrit

Një tejkalim i shpejtësisë maksimale të vendosur tregohet në kruskotin analog.

Cilësimet për paralajmërimin e shpejtësisë mund të kryhen në cilësimet e automjetit në sistemin Infotainment *Goma dimërore*.

## Treguesi i busullës

Nëse kuadri është i ndezur, atëherë ekrani i kruskotit, në varësi të pajimit, tregon anën aktuale të horizontit në formën e një shkurtimi, p.sh. VP për veriperëndim.

Nëse sistemi i Infotainment është i aktivizuar dhe nuk është aktiv asnjë udhëzues i destinacionit, atëherë është e disponueshme paraqitja grafike shtesë e busullës.

## Treguesit e kilometrave

Numëruesi i kilometrave në total regjistron të gjithë itinerarin e përshkuar të automjetit.

Numëruesi i kilometrazhit **trip (udhëtimi)** tregon kilometrat që janë përshkuar pas rivendosjes së fundit të numëruesit të kilometrazhit.

1. Rivendosni numëruesin e kilometrazhit nëpërmjet sistemit Infotainment ose nëpërmjet menysë së servisit *Menuja e shërbimit*.

## Aktivizimi i ventilatorit ftohës

Ky tregues shfaqet pas fikjes së kuadrit, nëse ventilatori ftohës është duke punuar me fikje të vonuar.

Një kohë e aktivizimit të ventilatorit ftohës mund të jetë e kushtëzuar nga:

—Ritrajtimi i gazeve, p.sh. në rastin e rigjenerimit të filtrit të grimcave.

—Ftohësi i frenave aktive pas nisjes tatëpjetë.

—Shpërndarja e nxehtësisë së motorit pas ngarkesave të mëdha, p.sh. në rastin e tërheqjes së rimorkios.

## Shkronjat identifikuese të motorit (MKB)

1. Hapni menynë e servisit *Menuja e shërbimit*.
2. Zgjidhni pikën e menysë **Engine code (Germa identifikuese e motorit)**.

## Udhëzimet e telefonit

Nëse një telefon celular është i lidhur nëpërmjet Bluetooth, atëherë në kruskotin analog shfaqet simboli Bluetooth.

Për më tepër, simboli tregon gjendjen e karikimit të baterisë së telefonit celular.

## Pozicioni i levës së marsheve

Pozicioni i vendosur i levës së marsheve tregohet si anash levës së marsheve, ashtu edhe në kruskotin analog.

Në pozicionin D/S të levës së marsheve, si dhe tek Tiptronic, në kruskotin analog shfaqet marshi përkatës, sipas rastit *Transmisioni automatik (kombinim)*.

## eco Gjendja e ngarjes më ekonomike

Gjatë ngarjes në kruskotit analog tregohet nëse automjeti është në një gjendje të ngarjes ekonomike.

Disa cilësime mund të ruhen te llogaritë e përdoruesve të personalizimit dhe për këtë arsye mund të ndryshojnë në mënyrë automatike kur ndryshohet llogaria e përdoruesit *Personalizimi*.

Ka kruskot të ndryshëm, prandaj versionet dhe treguesit në ekran mund të ndryshojnë. Në rastin e ekranit pa tregues të teksteve paralajmëruese ose informuese, defektet shfaqen vetëm nëpërmjet dritave të kontrollit.

Disa tregues në kruskotin analog mund të zbehen nëpërmjet ngjarjeve të shfaqura papritur, p.sh. telefonatat hyrëse.

Në varësi të pajimit, disa cilësime dhe tregues mund të bëhen edhe në sistemin Infotainment.

## Treguesi matës i numrit të xhirove

Fillimi i fushës së kuqe në treguesin matës të numrit të xhirove tregon për të gjitha marshet xhirot maksimale të lejuara të motorit kur shtrohet dhe kur është i ngrohtë.

Përpara arritjes së fushës së kuqe duhet futur marshi tjetër më i lartë, duhet zgjedhur pozicioni D/S i levës së marsheve ose duhet hequr këmba nga pedali i gazit.

*UDHËZIM*

- Në rastin kur motori është i ftohtë shmangni xhirot e larta të motorit, gazin e plotë dhe ngarkesën e lartë të motorit.
- Për të shmangur dëmet në motor, treguesi matës i numrit të xhirove duhet të gjendet vetëm për një kohë të shkurtër në fushën e kuqe të shkallës.

Ndërrimi më herët i marshit ndihmon për të kursyer karburantin dhe për të reduktuar zhurmat e funksionimit.

## Treguesi digjital i rezervës së karburantit




**Fig. 1** Treguesi i rezervës së karburantit në kruskotin dixhital Pro (paraqitja me skicë).

**PARALAJMËRIM**

Udhëtimi me një sasi të vogël karburanti mund të shkaktojë ngecjen në trafik, aksidente dhe lëndime të rënda.

- Niveli tepër i ulët i karburantit mund të shkaktojë furnizimin jo të rregullit të motorit me karburant, sidomos kur udhëtoni në malore ose në rrugë me disheza.
- Sistemi i drejtimit, të gjitha sistemet e asistencës së drejtuesit të mjetit dhe sistemet që mbështesin sistemin e frenimit nuk punojnë kur motori „ngec“ ose fiket për shkak të mungesës së karburantit ose të furnizimit jo të rregullt me karburant.
- Për të evituar ngecjen e automjetit për shkak të mungesës së karburantit, kryeni gjithmonë furnizimin me karburant, kur serbatori është i mbushur me vetëm 1/4 e tij.

***UDHËZIM***

Mos udhëtoni kurrë deri sa serbatori i karburantit të boshatiset plotësisht. Nëpërmjet furnizimit jo të rregullt me karburant, mund të shkaktohen ndezje të gabuara dhe sasi jo të djegura karburanti në sistemin e shkarkimit të gazeve.

Shigjeta e vogël pranë simbolit të pompës së karburantit tek treguesi i rezervës së karburantit tregon se në cilën anë të automjetit gjendet tapa e rezervuarit të karburantit.

## Treguesi analog i rezervës së karburantit




**Fig. 1** Treguesi i rezervës së karburantit në kruskotin analog (paraqitja me skicë).

**⚠ PARALAJMËRIM**

Udhëtimi me një sasi të vogël karburanti mund të shkaktojë ngecjen në trafik, aksidente dhe lëndime të rënda.

- Niveli tepër i ulët i karburantit mund të shkaktojë furnizimin jo të rregullit të motorit me karburant, sidomos kur udhëtoni në malore ose në rrugë me disheza.
- Sistemi i drejtimit, të gjitha sistemet e asistencës së drejtuesit të mjetit dhe sistemet që mbështesin sistemin e frenimit nuk punojnë kur motori „ngec" ose fiket për shkak të mungesës së karburantit ose të furnizimit jo të rregullt me karburant.
- Për të evituar ngecjen e automjetit për shkak të mungesës së karburantit, kryeni gjithmonë furnizimin me karburant, kur serbatori është i mbushur me vetëm 1/4 e tij.

***UDHËZIM***

Mos udhëtoni kurrë deri sa serbatori i karburantit të boshatiset plotësisht. Nëpërmjet furnizimit jo të rregullt me karburant, mund të shkaktohen ndezje të gabuara dhe sasi jo të djegura karburanti në sistemin e shkarkimit të gazeve.

Shigjeta e vogël pranë simbolit të pompës së karburantit tek treguesi i rezervës së karburantit tregon se në cilën anë të automjetit gjendet tapa e rezervuarit të karburantit.

## Zgjidhjet e problemeve

### Serbatori i karburantit pothuajse bosh

Drita e kontrollit ndriçon në ngjyrë të verdhë. Sasia e rezervës (shenja e kuqe) po konsumohet.

1. Kur t'ju jepet mundësia tjetër bëni furnizimin me karburant.

Kur ndizet drita e kontrollit ngrohësi ndihmës dhe ngrohësi plotësues që punon me karburant fiken në mënyrë automatike.

### Ujë në naftë

Drita e kontrollit ndriçon në ngjyrë të verdhë.

1. Ulni menjëherë shpejtësinë dhe kontaktoni një oficinë të specializuar dhe të kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

   **Ose:** Nëse drita paralajmëruese ndriçon direkt pas mbushjes me karburant, **Mos vazhdo me tej udhëtimin!** Fikni motorin dhe merrni menjëherë ndihmë teknike të specializuar.

## Treguesi digjital i temperaturës së substancës ftohëse të motorit




**Fig. 1** Treguesi i temperaturës së lëngut ftohës të motorit në kruskotin dixhital Pro (paraqitja me skicë).

- (A) Zona e ftohtë. Motori nuk ka arritur ende temperaturën e punës. Mënjanoni xhirot e larta të motorit dhe ngarkesën e fortë të motorit, për sa kohë motori nuk ka arritur ende temperaturën e punës.
- (B) Zona normale.
- (C) Zona paralajmëruese. Kur ngarkesa e motorit është e fortë – sidomos në temperatura të larta të mjedisit – shiriti mund të lëvizë në zonën paralajmëruese.

Nëse drita e kontrollit pulson, temperatura e lëngut ftohës të motorit është tepër e lartë ose niveli i lëngut ftohës të motorit është tepër i ulët *Lënda ftohëse e motorit*.

## Treguesi analog i temperaturës së substancës ftohëse të motorit




**Fig. 1** Treguesi i temperaturës së lëngut ftohës të motorit në kruskotin analog (paraqitje ilustruese).

- (A) Zona e ftohtë. Motori nuk ka arritur ende temperaturën e punës. Mënjanoni xhirot e larta të motorit dhe ngarkesën e fortë të motorit, për sa kohë motori nuk ka arritur ende temperaturën e punës.
- (B) Zona normale.
- (C) Zona paralajmëruese. Kur ngarkesa e motorit është e fortë – sidomos në temperatura të larta të mjedisit – treguesi mund të lëvizë në zonën paralajmëruese.

Nëse drita e kontrollit pulson, temperatura e lëngut ftohës të motorit është tepër e lartë ose niveli i lëngut ftohës të motorit është tepër i ulët *Lënda ftohëse e motorit*.

## Ekrani Head-up (HUD)




**Fig. 1** Pranë timonit: Rregullatori për ekranin Head-up (Shigjetë).




**Fig. 2** Në panelin e instrumenteve mbi timon: Shembuj të figurës së shfaqur në ekranin Head-up.

Ekrani "Head-up" projekton treguesit e përzgjedhur të informacionit ose mesazhe paralajmëruese nga sistemet e asistencës ose nga sistemi i Infotainment në fushëpamjen e drejtuesit të mjetit.

## Ndezja dhe fikja e ekranit Head-up

1. Për ta ndezur dhe fikur ekranin Head-up (HUD), shtypni mbi rregullatorin → *fig. 1* .

## Cilësimet e lartësisë

Për ta përshtatur në mënyrë individuale këndin e shikimit, lartësia e ekranit Head-up konfigurohet si më poshtë:.

1. Marrja e pozicionit optimal të uljes.
2. Konfigurimi i lartësisë së dëshiruar të ekranit Head-up me rregullatorin → *fig. 1* .

## Cilësimet në sistemin e Infotainment

Te cilësimet e automjetit në sistemin Infotainment mund të kryhen cilësime të tjera për ekranin Head-up.

Në nënmenynë **Display (Ekrani)**:

— Cilësimi i ndriçimit të figurës dhe të skemës së ngjyrave të ekranit Head-up.

Në nënmenynë **Contents (Përmbajtjet)**:

— Përzgjedhja e përmbajtjes së asaj që tregohet në ekranin Head-up, p.sh. tregimi i sistemeve të asistencës së drejtuesit të mjetit.

— Skema alternative e ngjyrave të ekranit Head-up në kushte të këqija moti, p.sh kur ka reshje bore.

**UDHËZIM**

Ekrani Head-up mund të dala nga shina udhëzuese nëse ushtrohet shumë presion, p.sh. gjatë pastrimit.

- Mos e pastroni kurrë ekranin Head-up duke ushtruar shumë presion.

**UDHËZIM**

Për të mënjanuar gërvishtjen e xhamit mbulues, mos vendosni kurrë objekte në hapësirën e daljes së ekranit Head-up.

**UDHËZIM**

Nëse ekrani Head-up ngrohet për shkak të rrezeve të forta të diellit, sistemi mund të fiket automatikisht. Ekrani Head-up ndizet përsëri, sapo të ftohet në mënyrë të mjaftueshme.

Përmbajtjet e figurës nuk mund të hiqen, p.sh. mesazhet paralajmërues.

Ndriçimi i figurës reduktohet në mënyrë automatike me uljen e ndriçimit të mjedisit. Ndriçimi bazë konfigurohet bashkë me ndriçimin e instrumenteve *Ndriçimi i instrumenteve dhe i çelësit*.

Për shkak të rrezatimit jo favorizues të diellit mund të shfaqen refleksione.

Syzet e diellit me filtra polarizues mund të ndikojnë negativisht te tregimi.

Lexueshmëria optimale e ekranit Head-up varet nga pozicioni i uljes dhe cilësimet e lartësisë së ekranit Head-up.

Pastrojeni ekranin Head-up vetëm me një leckë të butë dhe me substanca të buta pastrimi. Pecetat me mikrofibra mund të gërvishtin ekranin Head-up.

Disa cilësime mund të ruhen te llogaritë e përdoruesve të personalizimit dhe për këtë arsye mund të ndryshojnë në mënyrë automatike kur ndryshohet llogaria e përdoruesit *Personalizimi*.

**Treguesi i të dhënave të udhëtimit (treguesi multifunksional)**

Treguesi i të dhënave të udhëtimit (treguesi multifunksional) tregon vlerat e udhëtimit dhe të konsumit. Në varësi të pajimit të automjetit mund të tregohen të dhëna të ndryshme të udhëtimit. Të dhënat e treguara të udhëtimit varen nga mënyra aktuale e drejtimit, nga gjendja e automjetit, p.sh. rigjenerim i filtrit të grimcave dhe nga situata aktuale e udhëtimit, p.sh. trafik qytetit. Të dhënat e udhëtimit përcaktohen si vlerë mesatare për segmente të ndryshme të gjata, dhe për këtë arsye vlera që tregohet aktualisht mund të mos përputhet me vlerën mesatare reale.

## Kalimi përmes treguesve të ndryshëm

Automjetet me timon multifunksional:

1. Shtypni butonin △ ose ▽ në timonin multifunksional.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Shtypni bilancierin TRIP në levën e fshirëses së xhamave.

## Ndryshimi i memories

Automjetet me timon multifunksional:

1. Shtypni butonin OK në timonin multifunksional.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Shtypni butonin OK/RESET në levën e fshirëseve të xhamave.

## Memoria Since start (Nga nisja)

Kur udhëtimi ndërpritet më shumë se 2 orë, memoria fshihet.

## Memoria Since refuelling (Nga furnizimi me karburant)

Tregimi dhe ruajtja e vlerave të grumbulluara të udhëtimit dhe të konsumit. Kur kryhet furnizimi me karburant, memoria fshihet.

### Memoria Long-term (Afatgjatë)

Memoria grumbullon vlerat e udhëtimit deri në 19 orë dhe 59 minuta ose 99 orë dhe 59 minuta kohë udhëtimi ose 1999.9 km (mi) ose 9999.9km (mi) distancë udhëtimi. Nëse tejkalohet një nga këto limite maksimale, memoria fshihet. Limitet maksimale ndryshojnë në varësi të modelit të kruskotit.

## Fshirja e memories së të dhënave të udhëtimit

Automjetet me timon multifunksional:

1. Zgjidhni memorien e cila duhet të fshihet.
2. Shtypni butonin OK në timonin multifunksional.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Zgjidhni memorien e cila duhet të fshihet.
2. Shtypni butonin OK/RESET në levën e fshirëseve të xhamave.

## Vendosja e paralajmërimit të shpejtësisë

Automjetet me timon multifunksional:

1. Zgjidhni treguesin **Warning at --- km/h (Paralajmërim në --- km/h)** ose **Warning at --- mph (Paralajmërim në --- mph)**.
2. Për të ruajtur shpejtësinë aktuale dhe për të aktivizuar paralajmërimin, shtypni butonin OK në timonin multifunksional.
3. Vendosni shpejtësinë brenda 5 sekondave me butonat shigjetë △ dhe ▽ në timonin multifunksional. Më pas, shtypni butonin OK ose prisni disa sekonda.

   Shpejtësia ruhet dhe paralajmërimi aktivizohet.
4. Për ta çaktivizuar shtypni përsëri butonin OK.

   Shpejtësia e ruajtur fshihet.

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Zgjidhni treguesin **Warning at --- km/h (Paralajmërim në --- km/h)** ose **Warning at --- mph (Paralajmërim në --- mph)**.
2. Për të ruajtur shpejtësinë aktuale dhe për të aktivizuar paralajmërimin, shtypni butonin OK/RESET në levën e fshirëses së xhamave.
3. Vendosni shpejtësinë brenda 5 sekondave me bilancierin TRIP në levën e fshirëses së xhamave. Më pas, shtypni butonin OK/RESET ose prisni disa sekonda.

   Shpejtësia ruhet dhe paralajmërimi aktivizohet.
4. Për ta çaktivizuar shtypni përsëri butonin OK/RESET.

   Shpejtësia e ruajtur fshihet.

Paralajmërimi mund të vendoset për shpejtësitë nga 30 km/h (18 mph) deri në 250 km/h (155 mph).

Sipas specifikimit të vendeve, në shpejtësi mbi 80 km/h (rreth 50 mph) jepet një paralajmërim akustik vetëm një herë dhe nga 120 km/h (rreth 75 mph) lëshohet një tingull paralajmërues i vazhdueshëm. Përveç kësaj, në ekranin e kruskotit tregohet drita e kontrollit. Ky paralajmërim është i detyrueshëm me ligj dhe nuk mund të ndryshohet.

## Të dhënat e udhëtimit në sistemin Infotainment

Në sistemin Infotainment mund të tregohen gjithashtu të dhënat e udhëtimit për treguesin në kruskot.

## Zgjedhja e treguesve

Të dhënat e udhëtimit që duhen shfaqur mund të konfigurohet te cilësimet e automjetit në sistemin Infotainment *Menuja e cilësimeve të automjetit*.

## ∅Consumption (Konsumi)

Konsumi mesatar i karburantit tregohet pas rreth 300 m (984 ft.).

## Range (Autonomia)

Distanca e përafërt në km (mi), e cila mund të përshkohet ende me të njëjtën mënyrë drejtimi.

## SCR-Range (Autonomia SCR) ose Range (Autonomia)

Distanca e përafërt në km (mi), e cila mund të përshkohet ende me sasinë ekzistuese të mbushjes së serbatorit të karburantit AdBlue®, me të njëjtën mënyrë drejtimi. Nëse është e mundur një rritje e autonomisë nëpërmjet rimbushjes, atëherë për këtë tregohet gjithashtu sasia e nevojshme e rimbushjes.

## ∅Speed (Shpejtësia)

Shpejtësia mesatare shfaqet pas rreth 100 metrash (rreth 328 ft.).

**⚠ PARALAJMËRIM**

Nëse drejtuesi i mjetit shpërqendrohet gjatë udhëtimit, mund të shkaktohen aksidente dhe lëndime të rënda.

- Mos e përdorni kurrë kruskotin gjatë udhëtimit.
- Kryejini të gjitha konfigurimet në kruskot dhe në sistemin Infotainment vetëm kur automjeti të jetë i ndaluar.

Disa cilësime mund të ruhen te llogaritë e përdoruesve të personalizimit dhe për këtë arsye mund të ndryshojnë në mënyrë automatike kur ndryshohet llogaria e përdoruesit *Personalizimi*.

# Menyja e servisit

Në menynë e servisit, në varësi të pajisjes mund të kryhen cilësime.

## Hapja e menysë së servisit

1. Zgjidhni profilin e informacionit **Range (Autonomia)** në kruskot.
2. Mbani shtypur për 4 sekonda butonin OK në timonin multifunksional.
3. Me butonin në timonin multifunksional navigoni në meny.

## Rikthimi në gjendjen fillestare të treguesit të intervalit të servisit

1. Zgjidhni menynë **Service (Servisi)**.
2. Ndiqni udhëzimet në ekranin e kruskotit.

## Rikthimi në gjendjen fillestare të servisit të ndërrimit të vajit

1. Zgjidhni menynë **Reset Oil Service (Rivendos servisin e ndërrimit të vajit)**.
2. Ndiqni udhëzimet në ekranin e kruskotit.

## Rikthimi në gjendjen fillestare i numëruesit të kilometrazhit

1. Zgjidhni menynë **Reset trip (Rikthimi në gjendjen fillestare i udhëtimit)**.
2. Ndiqni udhëzimet në ekranin e kruskotit.

## Treguesi i shkronjave identifikuese të motorit (MKB)

1. Zgjidhni menynë **Engine code (Germa identifikuese e motorit)**.

   Shkronja identifikuese e motorit shfaqet në ekranin e kruskotit.

## Vendosja e orës

1. Zgjidhni menynë **Time (Ora)**.
2. Rregulloni orën me butonat shigjetë △ ose ▽.

## Tregimi i informacioneve Copyright

1. Për të thirrur informacionet Copyright, zgjidhni menynë **Copyright (E drejta e autorit)**.

# Treguesi i intervalit të servisit

Tregimet mbi rastet e servisit kryhen në ekranin e kruskotit dhe në sistemin Infotainment. Ekzistojnë modele të ndryshme të kruskotit dhe të sistemit të informimit dhe argëtimit, prandaj afishimet në ekrane mund të ndryshojnë.

Datat e servisit te Volkswagen klasifikohen në servise për ndërrimin e vajit dhe inspektime. Treguesi i intervalit të servisit ju informon mbi datën tjetër të servisit që përmban një ndërrim të vajit të motorit, dhe mbi inspektimin tjetër që duhet kryer.

Tek automjetet me interval të përcaktuar të ndërrimit të vajit, intervalet e servisit janë paracaktuar.

Tek automjetet me servis fleksibël të ndërrimit të vajit, intervalet përcaktohen në mënyrë individuale. Një servis për ndërrimin e vajit duhet të kryhet vetëm atëherë nëse automjeti ka nevojë për atë. Gjatë këtij procesi merren parasysh edhe kushtet individuale të përdorimit dhe stili personal i të udhëtuarit. Paralajmërimi i servisit tregohet herën e parë 30 ditë para servisit të llogaritur të ndërrimit të vajit që duhet të kryhet. Distanca e mbetur për tu udhëtuar e treguar rrumbullakoset gjithmonë në 100 km (mi) dhe koha e mbetur në ditë të plota.

## Lajmërimi i servisit

Nëse së shpejti duhet të kryhet një servis i ndërrimi të vajit ose një inspektim, kur ndizet kuadri shfaqet një lajmërimi i servisit.

Numri i kilometrave ose koha e dhënë është distanca ose periudha kohore, që mund të kryhet deri tek servisi tjetër.

## Rastet e servisit

Në rastin kur duhet të kryhet një servis i ndërrimit të vajit ose kur duhet të kryhet një inspektim, gjatë ndezjes së kuadrit dëgjohet një sinjal akustik dhe për disa sekonda në ekranin e kruskotit mund të shfaqet një simbol i çelësit të vidave bashkë me një nga treguesit e mëposhtëm:

— **Inspection now! (Inspektimi tani!)**

— **Oil service now (Servisi i ndërrimit të vajit tani)!**

— **Oil service and inspection now! (Servisi i ndërrimit të vajit dhe inspektimi tani!)**

## Thirrja e datës së servisit në sistemin Infotainment

Kur kuadri është i ndezur, motori i fikur dhe automjeti qëndron mund të kontrollohet data aktuale e servisit:

1. Në varësi të modelit, shtypni butonin ose butonin e funksionit MENU dhe zgjidhni menynë **Vehicle (Automjeti)** në sistemin e Infotainment.

   **Ose:** Në varësi të versionit, shtypni butonin ose butonin e funksionit CAR.

2. Në varësi të modelit, zgjidhni menynë **Settings (Cilësimet)**.

3. Për të treguar informacionet e servisit, zgjidhni pikën e menysë **Service** (Servisi).

## Kërkimi i datës së servisit në kruskotin analog

1. Mbani të shtypur butonin [0.0] në kruskot deri sa të shfaqet shkrimi **Service (Servis)** në ekran.
2. Lëshojeni butonin [0.0].

   Data aktuale e servisit tregohet në ekran.

## Kërkimi i datës së servisit në kruskotin dixhital Pro

Kur kuadri është i ndezur, motori i fikur dhe automjeti qëndron mund të kontrollohet data aktuale e servisit:

1. Hapni menynë e servisit *Menuja e shërbimit*.

## Rikthimi në gjendjen fillestare të treguesit të intervalit të servisit

Nëse treguesi i intervalit të servisit pas servisit të ndërrimit të vajit ose inspektimit nuk u rikthye në gjendjen fillestare, treguesi mund të rikthehet në gjendjen fillestare si më poshtë:

Automjetet me kruskot analog:

1. Fikni kuadrin e automjetit.
2. Mbani të shtypur butonin [0.0] në kruskot.
3. Ndizeni përsëri kuadrin.
4. Lëshoni butonin [0.0], nëse një nga tekstet e mëposhtme shfaqet në ekranin e kruskotit: **Reset oil change service? (Rikthim në gjendjen fillestare i shërbimit të ndërrimit të vajit)** ose **Reset oil change service? (Rikthim në gjendjen fillestare i servisit të inspektimit)?**.
5. Shtypni butonin [0.0] në kruskot për ta aktivizuar.

*Automjetet me kruskot digjital:* Treguesi i intervalit të servisit mund të rikthehet në gjendjen fillestare nëpërmjet menysë së servisit *Menuja e shërbimit*.

Treguesin e intervalit të servisit mos e riktheni ndërmjet intervaleve të servisit, pasi përndryshe mund të ketë tregime të gabuara.

Nëse intervali i servisit të ndërrimit të vajit është rikthyer manualisht në gjendjen fillestare, treguesi i intervalit të servisit kalon më pas edhe tek automjetet me servis fleksibël për ndërrimin e vajit në një interval servisi të përcaktuar.

Mesazhi i servisit shuhet automatikisht pas disa sekondash kur motori është i ndezur ose duke shtypur butonin [OK] në timonin multifunksional.

Nëse bateria 12 V e automjetit tek automjetet me interval servisi fleksibël ka qenë e shkëputur për një kohë të gjatë, përllogaritja kohore për servisin tjetër të ndërrimit të vajit nuk është e mundur. Prandaj treguesit e intervalit të servisit mund të shfaqin përllogaritje të gabuara. Në këtë rast respektoni intervalet maksimale të lejuara të mirëmbajtjes.

# Ora

## Rregullimi i orës në sistemin e Infotainment

1. Në varësi të versionit, shtypni butonin ose butonin e funksionit MENU dhe hapni menynë **Vehicle (Automjeti)**.

   **Ose:** Në varësi të versionit, shtypni butonin ose butonin e funksionit CAR.
2. Në varësi të llojit të pajimit, hapni menynë **Settings** (Cilësimet).
3. Për të vendosur orën, zgjidhni pikën e menysë **Time and date (Ora dhe data)**.

## Rregullimi i orës në kruskotin dixhital Pro

1. Zgjidhni profilin e informacionit **Range (Autonomia)**.
2. Mbani të shtypur butonin OK në timonin multifunksional për aq kohë derisa menyja e servisit të jetë e disponueshme në ekranin e kruskotit *Menuja e shërbimit*.
3. Zgjidhni menynë **Time (Ora)**.
4. Vendosni orën e saktë me butonat shigjetë △ ose ▽.

## Rregullimi i orë në kruskotin analog

1. Për të rregulluar të gjitha orët në automjet, mbani shtypur për aq kohë butonin 0.0 në kruskotin analog, derisa në ekranin e kruskotit të shfaqet shkrimi **Time (Ora)**.
2. Lëshojeni butonin 0.0.

   Ora tregohet dhe treguesi i orëve është i theksuar.
3. Shtypni butonin 0.0 aq herë derisa të tregohet numri i orëve që dëshironi.

   Për të ecur shpejt mbani të shtypur butonin 0.0.

   Pas disa sekondash kalohet automatikisht në treguesin e minutave.
4. Shtypni butonin 0.0 aq herë derisa të tregohet numri i minutave që dëshironi.

   Për të ecur shpejt mbani të shtypur butonin 0.0.
5. Për ta përfunduar vendosjen e orës, lëshoni butonin 0.0.

## Laptimer Sistemi i Infotainment




**Fig. 1** Në ekranin e sistemit Infotainment: Laptimer me kronometër, butonat e funksionit dhe kohët e xhirove.




**Fig. 2** Butoni i funksionit në ekranin e sistemit Infotainment: Matja e kohës për xhirot

A që janë ndalur,

B që janë në vazhdim dhe

C xhirot e përfunduara.

---

1 Kronometër.

2 Butoni i funksionit me orën aktuale të xhirove.

3 Orët e ruajtura të xhirove.

4 Nisni ose vazhdoni matjen e kohës, kjo është e mundur vetëm kur kuadri është i ndezur. Prekni **Start (Nis)**, për të filluar matjen e kohës. Matja e kohës fillon automatikisht nëse automjeti lëviz përpara. Nëse të dhënat janë rivendosur në sistemin e statistikave, atëherë mund të niset nga e para një xhiro e re.

5 Ndërpritni xhiron aktuale. Ora e xhirove fshihet. Në sistemin e statistikave shfaqet --:--:--.--.

6 Përfundoni matjen e kohës.

7 Ndalni matjen e kohës ose ndërpritni xhiron aktuale në rastin e matjes së kohës në vazhdim.

8 Nisni xhiro të re. Ora e xhirove të fundit ruhet dhe fillon një xhiro e re. Koha e përgjithshme e xhirove shfaqet në sistemin e statistikave.

9 Shfaqni kohën e ndërmjetme. Kronometri ndalon për disa sekonda dhe shfaqet koha e ndërmjetme.

10

Pas përfundimit ose ndërprerjes së matjes së kohës shfaqni statistikat: numri i xhirove, koha e përgjithshme, xhiroja më e shpejtë dhe më e ngadaltë, vlera mesatare e të gjitha orëve të xhirove, të gjitha vlerat e xhirove. Shtypni **Reset (Rikthe)** për të rikthyer statistikat në gjendjen fillestare.

Mund të shënohen maksimalisht 99 xhiro dhe një kohëzgjatje maksimale prej 99 orësh, 59 minutash dhe 59 sekondash. Nëse është arritur një nga këto kufizime, atëherë të dhënat duhet të fshihen në sistemin e statistikave përpara një matjeje tjetër të kohës.

## Hapja e Laptimer

1. Në varësi të versionit, shtypni butonin ose butonin e funksionit [MENU].

   **Ose:** Shtypni butonin ose butonin e funksionit [CAR].

   **Ose:** Prekni butonin e funksionit [⚙].
2. Prekni butonin e funksionit [Vehicle (Automjeti)].

   **Ose** Prekni butonin e funksionit [Auto].
3. Prekni butonin e funksionit [Selection] (Zgjedhja).
4. Prekni sipërfaqen e funksionit [Sport].

   Shfaqet monitori i fuqisë.
5. Për të kaluar te Laptimer, prekni një nga butonat shigjetë në monitorin e fuqisë.

Me butonin shigjetë ju mund të kaloni në çdo kohë midis Laptimer dhe monitorit të fuqisë.

## Matja e orëve të xhirove

Kronometri mat orët e xhirove në dy fusha:

Treguesi i kuq dhe vlera e numrit në qendër tregojnë me sekonda kohën në vazhdim, treguesi i vogël në fushën e brendshme tregon minutat dhe orët.

Treguesi në anën e djathtë tregon orën aktuale të xhirove me një saktësi prej 1/100 sekondave. Nëse nuk është ruajtur asnjë xhiro me kohët e ndërmjetme në Laptimer, atëherë nuk ka asnjë shmangie ndërmjet kohës së kronometrit dhe kohës së xhirove.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Nëse shoferi shpërqendrohet mund të shkaktojë aksidente dhe lëndime.

- Kryejini cilësimet paraprake të Laptimer dhe hapjen e statistikave vetëm kur automjeti është i ndaluar.
- Përdoreni Laptimer gjatë udhëtimit vetëm në situata udhëtimi që kontrollohen me lehtësi.

## Performance monitor




**Fig. 1** Në ekranin e sistemit Infotainment: Monitori i fuqisë.

(1) Fushat e treguesve.

(2) Butonat shigjetë për kalimin te Laptimer.

Monitori i fuqisë është një tregues për ngarjen sportive. Instrumentet digjitale tregojnë në kohë reale vlerat e fuqisë së elektromotorit, temperaturën dhe treguesin e përshpejtimit që transmetohen në automjet nëpërmjet sensorëve. Në këtë mënyrë shoferi ka një pamje të përgjithshme për dinamikën e ngarjes.

### Hapja e monitorit të fuqisë

1. Në varësi të versionit shtypni butonin ose butonin e funksionit MENU në sistemin Infotainment.
2. Prekni butonin e funksionit Vehicle (Automjeti).
3. Prekni butonin e funksionit Selection (Zgjedhja).
4. Prekni sipërfaqen e funksionit Sport.

Nëse dëshironi të kaloni midis monitorit të fuqisë dhe Laptimer, atëherë prekni një nga butonat shigjetë majtas dhe djathtas sipër instrumenteve te → *fig. 1* (2).

### Zgjidhni instrumentet dhe konfiguroni njësitë

Ekrani mund të tregojë maksimalisht tre instrumentet në të njëjtën kohë. Çdo instrument është i zgjedhshëm për çdo fushë të treguesit → *fig. 1* (1) (majtas, në mes, djathtas).

1. Për të kaluar ndërmjet instrumenteve, kaloni me gisht në drejtimin vertikal mbi monitor.

   Instrumenti aktual i zgjedhur zhduket dhe shfaqet një instrument i ri.

Tek disa instrumente mund të konfigurohet njësia në sistemin Infotainment *Menuja e cilësimeve të automjetit*.

## Për instrumentet e mëposhtme mund të shfaqen:

—**Treguesi i presionit të karikimit:** Treguesi i presionit të karikimit → *fig. 1* (1) (majtas) tregon presionin në rrugën e ajrit të karikimit midis turbinës dhe motorit në bar. Sa më djathtas të jetë treguesi në shkallë, aq më e madhe është fuqia që jep elektromotori.

—**Matësi i përshpejtimit (G-Meter):** Matësi i përshpejtimit (G-Meter) → *fig. 1* (1) (në mes) tregon në fushën e mesit vlerën e përshpejtimit në g. Shenja e kuqe në fushën me formë rrjete tregon forcën e përshpejtimit dhe drejtimin e forcës. Forca, në përputhje me ligjet e fizikës, vepron në drejtimin e kundërt. Nëse p.sh. ngisni majtas, atëherë shenja e kuqe lëviz në fushën e djathtë të instrumentit dhe e kundërta. Nëse përshpejtoni, atëherë shenja e kuqe lëviz poshtë. Nëse frenoni, atëherë shenja e kuqe lëviz sipër. Forca e përshpejtimit tregohet nëpërmjet pozicionit të shenjës së kuqe nga brenda jashtë. Nëse treguesi i përshpejtimit rritet, atëherë shenja e kuqe largohet nga fusha në mes.

—**Treguesi i fuqisë:** Treguesi i fuqisë → *fig. 1* (1) (djathtas) tregon fuqinë aktuale të kërkuar të elektromotorit si vlerë digjitale dhe në shkallë të shtrirë në kW.

—**Treguesi i temperaturës së lëngut ftohës të motorit:** Në rastin e ngarkesës së lartë të motorit dhe temperaturës së jashtme të lartë treguesi në këtë rast lëviz më tej në sensin e akrepave të orës. Kjo është e padëmshme, për sa kohë që drita e kontrollit në ekranin e kruskotit nuk qëndron ndezur ose nuk pulson *Lënda ftohëse e motorit*.

—**Treguesi i temperaturës së vajit:** Nën kushtet normale të ngarjes treguesi qëndron në fushën në mes. Nëse treguesi qëndron në fushën poshtë majtas, atëherë temperatura e funksionimit të elektromotorit nuk është arritur ende. Nëse elektromotori nuk e ka arritur ende temperaturën e funksionimit, atëherë shmangni shpejtësitë dhe treguesin e përshpejtimit të lartë. Në rastin e ngarkesës së lartë të elektromotorit dhe temperaturës së jashtme të lartë treguesi në këtë rast lëviz më tej në sensin e akrepave të orës. Kjo është e padëmshme, për sa kohë që drita e kontrollit në ekranin e kruskotit nuk qëndron ndezur ose nuk pulson *Vaji i motorit*.

## Përshtatja e zonave të tregimit me situatat e udhëtimit

Zgjidhni tre instrumente të mundshëm në përputhje me sjelljen individuale dhe situatën e ngarjes.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Nëse shoferi shpërqendrohet mund të shkaktojë aksidente dhe lëndime. Përdorimi i sistemit Infotainment mund t'ju tërheqë vëmendjen nga situata e trafikut.

- Udhëtoni gjithmonë me kujdes dhe me përgjegjësi.

***UDHËZIM***

Pas ndezjes së elektromotorit të ftohtë shmangni xhirot e larta të motorit, gazin e plotë dhe ngarkesën e lartë të elektromotorit.

Për shkak të parimit të disponueshëm në automjet të përcaktimit të performancës, vlerat e shfaqura nuk kanë asnjë pretendim për saktësinë fizike.

# Menyja e cilësimeve të automjetit

Në cilësimet e automjetit të sistemit Infotainment mund të aktivizoni dhe çaktivizoni funksione dhe sisteme individuale si dhe të kryeni cilësime.

## Hapja e menysë Vehicle settings (Cilësimet e automjetit)

1. Ndizni kuadrin.
2. Nëse është e nevojshme ndizni sistemin Infotainment.
3. Në varësi të pajisjes, shtypni butonin ose butonin e funksionit MENU dhe zgjidhni menynë **Vehicle (Automjeti)**.

   **Ose:** Në varësi të modelit, shtypni butonin ose butonin e funksionit CAR dhe zgjidhni menynë **Settings (Cilësimet)**.

   **Ose:** Prekni butonin e funksionit ⚙ dhe zgjidhni menynë **Vehicle (Automjeti)**.
4. Për të thirrur meny të tjera në menynë **Vehicle settings (Cilësimet e automjetit)** ose për të kryer cilësimet në pikat e menysë, prekni butonin e funksionit dhe zgjidhni butonin përkatës të funksionit.
5. Për t'u kthyer te menyja e mëparshme, prekni butonin e funksionit ↩.

Një grep ☑ identifikon që funksioni përkatës është i ndezur.

## Cilësimet e sistemit dhe treguesi i informacioneve të automjetit

—Cilësimet e automjetit (Setup).

—Në varësi të pajisjes: Think Blue. Trajner *Think Blue. Trainer.*.

—Në varësi të pajimit: Monitori i fuqisë *Monitori i performancës*.

—Në varësi të pajimit: Laptimer *Lap timer në sistemin e informimit dhe argëtimit*.

—Treguesi jashtë rruge *Treguesi i ngarjes jashtë rruge*.

—Cilësimet e ngrohësit ndihmës.

—Kruskoti dixhital (Pro) *Kruskoti digjital (Pro)*.

—Mediat aktive.

—Të dhënat e udhëtimit.

—Statusi i automjetit.

—Zgjedhja e emisionit në radio.

Pas ndezjes së elektromotorit me baterinë e shkarkuar ose të ndërruar 12 volt të automjetit ose pas ndihmës së dhënë në ndezje, mund të jenë ndryshuar ose fshirë cilësimet e sistemit, p.sh. funksionet personale të komoditetit. Kontrolloni cilësimet dhe korrigjojini, pasi bateria 12 volt e automjetit të jetë karikuar përsëri mjaftueshëm.

**⚠ PARALAJMËRIM**

Nëse shoferi shpërqendrohet mund të shkaktojë aksidente dhe lëndime. Përdorimi i sistemit Infotainment mund t'ju tërheqë vëmendjen nga situata e trafikut.

- Udhëtoni gjithmonë me kujdes dhe me përgjegjësi.

## Hyrje për temën




**Fig. 1** Në ekranin e kruskotit: Simboli i identifikimit të lodhjes.

Identifikimi i lodhjes informon drejtuesin e mjetit, nëse sjellja e tij gjatë drejtimit të automjetit tregon që ai është i lodhur.

Identifikimi i lodhjes përcakton në fillimin e një udhëtimi mënyrën e sjelljes gjatë udhëtimit të drejtuesit të mjetit dhe llogarit nga kjo gjë një vlerësim të lodhjes. Vlerësimi krahasohet vazhdimisht me sjelljen aktuale gjatë udhëtimit të drejtuesit të mjetit. Nëse sistemi dallon lodhjen e drejtuesit të mjetit, ai informon në mënyrë akustike dhe optike në ekranin e kruskotit me anën e një simboli në që bashkohet me një mesazh plotësues me tekst → *fig. 1* . Mesazhi në ekranin e kruskotit tregohet për rreth 5 sekonda dhe ndoshta përsëritet edhe një herë. Mesazhi i kryer i fundit ruhet nga sistemi.

## Kushtet e funksionimit

Sjellja gjatë udhëtimit vlerësohet vetëm në shpejtësi mbi rreth 60km/h (rreth 37mph) deri në rreth 200km/h (rreth 125mph).

**⚠ PARALAJMËRIM**

Teknologjia inteligjente e identifikimit të lodhjes nuk mund të kapërcejë kufijtë e specifikuar fizikisht dhe funksionon vetëm brenda kufijve të sistemit. Rritja e komoditetit nëpërmjet identifikimit të lodhjes nuk duhet t'ju tundojë kurrë që të ndërmerrni veprime që janë të rrezikshme për sigurinë. Në rastin e udhëtimeve të gjata bëni rregullisht dhe mjaftueshëm pushime.

- Përgjegjësia për aftësinë vetjake për të udhëtuar mbetet gjithmonë te drejtuesi i mjetit.
- Mos drejtoni kurrë një automjet në gjendje të lodhur.
- Sistemi nuk e dallon lodhjen e drejtuesit të mjetit në të gjitha rrethanat. Kushtoni vëmendje informacioneve në paragrafin Kufijtë e dallimit të lodhjes.
- Sistemi në disa situata mund të interpretojë një manovër të kryer me dëshirë nga ana e drejtuesit të mjetit në mënyrë të gabuar si lodhje e drejtuesit të mjetit.
- Kryhet një paralajmërim akut në të ashtuquajturin mikrogjumë!
- Kushtojini vëmendje treguesve në ekranin e kruskotit dhe veproni në përputhje me kërkesat.

Identifikimi i lodhjes është zhvilluar për udhëtimet në autostrada dhe rrugë me cilësi të mira.

Kontrollojeni sistemin në rastin e një defekti pranë një ndërmarrje të specializuar të kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

## Kufijtë e dallimit të lodhjes

Identifikimi i lodhjes ka kufij të kushtëzuara nga sistemi. Kushtet e mëposhtme mund të shkaktojnë që identifikimi i lodhjes të funksionojë vetëm në mënyrë të kufizuar ose madje të mos funksionojë fare:

—Shpejtësitë nën rreth 60km/h (rreth 37mph).

—Shpejtësitë mbi rreth 200 km/h (rreth 125 mph).

—Rrugët me kthesa.

—Rrugët e këqija.

—Kushtet jo të përshtatshme të motit.

—Mënyra sportive e të udhëtuarit.

—Udhëtimet me rimorkiot e rënda ose të gjata *Funksioni i rimorkios*.

—Shpërqendrim i fortë i drejtuesit të mjetit.

Në situatat e mëposhtme identifikimi i lodhjes kthehet në gjendjen fillestare:

—Kuadri është i fikur.

—Rripi i sigurisë i drejtuesit të mjetit është zgjidhur dhe dera e shoferit është hapur.

—Automjeti qëndron për më shumë se rreth 15 minuta.

Gjatë një udhëtimi të gjatë të ngadaltë nën rreth 60 km/h (rreth 37 mph) vlerësimi i lodhjes rikthehet automatikisht në gjendjen fillestare nga ana e sistemit. Te udhëtimet pasuese të shpejta sjellja gjatë udhëtimit llogaritet përsëri.

# Përdorimi i dallimit të lodhjes

## Heqja e njoftimit

Njoftimi në ekranin e kruskotit mund të hiqet si më poshtë ose zhduket vetë pas 5 sekondash:

Automjetet pa timon multifunksional:

1. Shtypni butonin OK/RESET në levën e fshirëseve të xhamave.

Automjetet me timon multifunksional:

1. Shtypni butonin OK në timonin multifunksional.

## Aktivizimi dhe çaktivizimi

Ju mund ta ndizni dhe fikni identifikimin e lodhjes në menynë **Assist systems (Sistemet e asistencës)** në sistemin Infotainment *Treguesi i të dhënave të automjetit (treguesi shumëfunksional)*.

Pas ndezjes së elektromotorit ndizet automatikisht identifikimi i lodhjes.

## Hyrje për temën

Identifikimi i shenjave të qarkullimit kap me anën e një kamere në këmbën e pasqyrës së brendshme shenjat e standardizuara të qarkullimit dhe informon mbi limitet e shpejtësisë dhe ndalimet e parakalimit. Brenda kufijve të sistemit, sistemi tregon gjithashtu shenja shtesë, p.sh. kufizimet e kufizuara në kohë ose kufizimet në rast lagështire. Edhe në rrugën pa tabela, sistemi mund të tregojë, sipas rastit, limitet aktuale të vlefshme të shpejtësisë.

Në Gjermani, sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit tregon në autostrada ose në rrugë të shpejtësisë së lartë përveç limiteve të shpejtësisë dhe ndalimeve të parakalimit, edhe shenjat e qarkullimit për heqjen e të gjitha detyrimeve në rrugë. Në të gjitha shtetet e tjera të zonës së përdorimit tregohet ndërkohë limiti aktual i vlefshëm i shpejtësisë.

Shenjat e qarkullimit që kapen nga identifikimi i shenjave të qarkullimit shfaqen në ekranin e kruskotit dhe të sistemit të informimit dhe argëtimit.

Në varësi të pajimit, shfaqet gjithashtu një tregues në ekranin Head-up.

### Treguesi i shenjave të qarkullimit




**Fig. 1** Në ekranin e kruskotit: Shembuj për treguesit e identifikimit të shenjave të qarkullimit.




**Fig. 2** Në ekranin e kruskotit: Shembuj për treguesit e identifikimit të shenjave të qarkullimit.




**Fig. 3** Në ekranin e kruskotit: Shembuj për treguesit e identifikimit të shenjave të qarkullimit.

Pas kontrollit dhe vlerësimit të informacionit nga kamera, nga sistemi i informimit dhe argëtimit dhe nga të dhënat aktuale të automjetit, sistemi i ndezur i identifikimit të shenjave të qarkullimit tregon deri në tre shenja qarkullimi të vlefshme me shenjat përkatëse shtesë → *fig. 1* , → *fig. 2* , → *fig. 3* :

Pozicioni 1:
: Shenja e qarkullimit që është aktualisht e vlefshme për drejtuesin e mjetit tregohet majtas në ekran, p.sh. kufiri i shpejtësisë **130 km/h** (**80 mph**).

Pozicioni 2:
: Një shenjë qarkullimi e cila është e vlefshme vetëm me kusht tregohet në pozicionin e dytë, p.sh. **100 km/h** (**60 mph**) „kur ka lagështirë".

Shenjat shtesë:
: Nëse fshirësja e xhamit të përparmë është aktive gjatë udhëtimit, shenja e vlefshme e qarkullimit me shenjën shtesë „kur ka lagështirë" zhvendoset p.sh. majtas në pozicionin e parë.

Pozicioni 3:
: Një shenjë tjetër qarkullimi mund të tregohet në pozicionin e tretë, p.sh. „Ndalimi kufizuar në kohë i parakalimit".

**PARALAJMËRIM**

Teknologjia inteligjente e sistemit të identifikimit të shenjave të qarkullimit nuk mund të kapërcejë kufijtë e specifikuar fizikisht dhe funksionon vetëm brenda kufijve të sistemit. Rritja e komoditetit nëpërmjet sistemit të identifikimit të shenjave të qarkullimit nuk duhet t'ju tundojë kurrë që të ndërmerrni veprime që janë të rrezikshme për sigurinë. Sistemi nuk mund ta zëvendësojë vëmendjen e drejtuesit.

- Gjithmonë përshtateni shpejtësinë dhe mënyrën e drejtimit të mjetit sipas kushteve të shikueshmërisë, kushteve të motit, gjendjes së rrugës dhe kushteve të qarkullimit rrugor.
- Kushtet e këqija të shikimit, errësira, reshjet e borës, shiu dhe mjegulla mund të shkaktojnë që shenjat e qarkullimit të mos tregohen ose të tregohen gabim nga ana e sistemit.
- Nëse fushëpamja e kamerës është e ndotur, e mbuluar ose e dëmtuar, funksionimi i sistemit të identifikimit të shenjave të qarkullimit mund të jetë i kufizuar.

**PARALAJMËRIM**

Këshillat mbi mënyrën e drejtimit dhe shenjat e qarkullimit të treguara nga sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit mund të ndryshojnë nga situata aktuale e qarkullimit.

- Jo të gjitha shenjat e qarkullimit mund të dallohen dhe të tregohen saktë nga ana e sistemit.
- Shenjat e qarkullimit në rrugë dhe rregullat e qarkullimit kanë përparësi kundrejt këshillave të drejtimit dhe treguesit e sistemit të identifikimit të shenjave të qarkullimit.

***UDHËZIM***

Në regjimin e piketave të rrugës (navigimi me piketat e rrugës) të sistemit të informimit dhe argëtimit, sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit disponohet vetëm në mënyrë të kufizuar.

Disa cilësime mund të ruhen te llogaritë e përdoruesve të personalizimit dhe për këtë arsye mund të ndryshojnë në mënyrë automatike kur ndryshohet llogaria e përdoruesit *Personalizimi*.

# Kufijtë e identifikimit të shenjave të qarkullimit

## Njoftimet e gabimeve

**No road signs available (Nuk disponohet asnjë shenjë qarkullimi).**

Sistemi gjendet në fazën e inicializimit.

**Ose:** Kamera nuk ka dalluar asnjë shenjë detyruese ose ndaluese.

**Error: Dynamic Road Sign Display (Gabim: Identifikimi i shenjave të qarkullimit).**

Defekt i sistemit. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni një oficinë të specializuar dhe kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

**Speed warning currently unavailable. (Paralajmërimi i shpejtësisë nuk disponohet për momentin).**

Paralajmërimi i shpejtësisë i sistemit të identifikimit të shenjave të qarkullimit është me defekt. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni një oficinë të specializuar dhe kualifikuar për këtë gjë. Volkswagen rekomandon partnerin e Volkswagen.

**Dynamic Road Sign Display: clean windscreen! (Identifikimi i shenjave të qarkullimit: Pastro xhamin e përparmë!)**

Xhami i përparmë është bërë pis në zonën e kamerës ose fushëpamja e kamerës është e kufizuar për shkak të kushteve të motit. Pastroni xhamin e përparmë.

**Dynamic Road Sign Display is currently restricted. (Identifikimi i shenjave të qarkullimit është i kufizuar për momentin).**

Nuk kryhet transmetimi i të dhënave nga sistemi i Infotainment. Kontrolloni që sistemi i Infotainment është ngarkuar me të dhënat e vlefshme të hartave.

**Ose:** Automjeti gjendet në një zonë, e cila nuk është e përfshirë në hartën e vendosur në sistemin e Infotainment.

**No data existing. (Nuk ekzistojnë të dhëna).**

Identifikimi i shenjave të qarkullimit nuk mbështetet në vendin ku po udhëtoni aktualisht.

## Kufizimet funksionale

Sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit u nënshtrohet kufijve të kushtëzuara nga sistemi. Kushtet e mëposhtme mund të bëjnë që sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit të funksionojë vetëm në mënyrë të kufizuar ose madje të mos funksionojë fare:

- Temperaturat e larta të mjedisit ose rrezatimi i gjatë direkt i diellit.
- Shikim i keq, p.sh. kur bie borë.
- Verbim, p.sh. nga trafiku që vjen përballë ose rrezet e diellit.
- Shpejtësitë e larta.
- Kamera e mbuluar ose e ndotur.
- Shenja qarkullimi jashtë fushëpamjes së kamerës.
- Shenja qarkullimi të mbuluara pjesërisht ose plotësisht, p.sh. nga pemët, bora, papastërtitë ose nga automjete të tjera.
- Shenja qarkullimi, të cilat nuk përputhen me standardet.
- Shenja qarkullimi të dëmtuara ose të deformuara.
- Shenja qarkullimi të ndryshueshme tek urat për vendosjen e shenjave të qarkullimit (tregimet e ndryshueshme të shenjave të qarkullimit me anën LED ose mjeteve të tjera ndriçuese).
- Materiali i vjetruar i hartave të sistemit Infotainment.
- Ngjitëset mbi automjete, të cilat paraqesin shenja qarkullimi, p.sh. limitet e shpejtësisë mbi kamionë.

**Përdorimi i identifikimit të shenjave të qarkullimit**

## Aktivizimi dhe çaktivizimi

Tregimi i vazhdueshëm i shenjave të qarkullimit në kruskot mund të ndizet dhe fiket te cilësimet e automjetit në sistemin e informimit dhe argëtimit.

## Paralajmërimi i shpejtësisë

Nëse sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit dallon që tejkalohet një limit i vlefshëm shpejtësie, ai mund të paralajmërojë edhe në mënyrë akustike ose optike me një mesazh në ekranin e kruskotit.

Paralajmërimi i shpejtësisë mund të konfigurohet te cilësimet e automjetit në sistemin e informimit dhe argëtimit ose të çaktivizohet plotësisht *Menuja e cilësimeve të automjetit*. Konfigurimi kryhet në hapa prej 5 km/h (3 mph) brenda një diapazoni ndërmjet 0 km/h (mph) dhe 10 km/h (5 mph) mbi shpejtësinë më të lartë të lejuar.

## Regjimi i rimorkios

Tek automjetet me mekanizëm për tërheqjen e rimorkios të montuar në fabrikë dhe me një rimorkio të lidhur elektrikisht, tregimi i shenjave të qarkullimit lidhur për rimorkion, p.sh. limitet e vlefshme të shpejtësisë dhe ndalimet e parakalimit për automjetet me rimorkio, mund të aktivizohet ose të çaktivizohet te cilësimet e automjetit në sistemin e informimit dhe argëtimit *Menuja e cilësimeve të automjetit*.

Për regjimin e rimorkios, tregimi i limiteve të vlefshme të shpejtësisë mund të përshtatet me llojin e konstruksionit të rimorkios dhe me rregulloret ligjore. Konfigurimi kryhet në hapa prej 10 km/h (5 mph) brenda një diapazoni ndërmjet rreth 60 km/h (40 mph) dhe rreth 130 km/h (80 mph). Nëse konfigurohet një shpejtësi më e madhe se ajo që lejohet aktualisht në vendin e përdorimit për udhëtimet me rimorkio, sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit tregon në mënyrë automatike limitet ligjore normale të shpejtësisë, p.sh. në Gjermani rreth 80 km/h (50 mph).

Nëse paralajmërimi i shpejtësisë për rimorkion çaktivizohet, sistemi i identifikimit të shenjave të qarkullimit tregon limitet e shpejtësisë që përdoren për udhëtimet pa rimorkio.

# Personalizimi

Nëpërmjet personalizimit mund të ruhen cilësimet individuale të automjetit, p.sh. cilësimet e kondicionerit, në një llogari të përdoruesit We Connect. Identifikimi i përdoruesit bëhet nëpërmjet identifikimit në llogarinë tuaj të përdoruesit We Connect në sistemin Infotainment.

Ndryshimet në cilësime i caktohen llogarisë aktive të përdoruesit në automjet dhe nëse ekziston një lidhje interneti ruhen automatikisht online në llogarinë e përdoruesit We Connect.

## Përshëndetja dhe zgjedhja e llogarisë së përdoruesit

Pas ndezjes së kuadrit në sistemin Infotainment shfaqet emri i përdoruesit të identifikuar. Identifikimi i përdoruesit bëhet nëpërmjet çelësit të automjetit nëse aktivizohet caktimi automatik i çelësit. Nëse caktimi automatik i çelësit nuk është aktiv, atëherë në automjet shfaqet gjithmonë përdoruesi i regjistruar së fundmi.

Nëse nuk jeni përdoruesi i identifikuar, atëherë keni mundësitë e mëposhtme:

—Zgjidhni llogarinë tuaj të përdoruesit nga lista e përdoruesve nëse jeni regjistruar tashmë në automjet.

—Regjistrohuni me të dhënat tuaja të aksesit në llogarinë tuaj të përdoruesit We Connect dhe shtojini listës së përdoruesve llogarinë tuaj të përdoruesit.

—Krijoni një llogari të re përdoruesi direkt nga automjeti nëse nuk jeni regjistruar ende te We Connect.

Nëse nuk jeni regjistruar te We Connect ose nëse doni të regjistroheni nga e para, atëherë në sistemin Infotainment është në dispozicion një llogari e përdoruesit vizitor. Gjatë kalimit te llogaria e përdoruesit vizitor ruhen cilësimet aktuale të automjetit.

Pasi të jeni regjistruar, cilësimet e ruajtura online të automjetit ngarkohen dhe aktivizohen në automjet. Nëse regjistroheni për herë të parë në një automjet me llogarinë tuaj të përdoruesit, atëherë filloni me cilësimet e fabrikës.

Nëse automjeti disponon funksionin e memories nëpërmjet sediljeve, atëherë ju mund ta ndërprisni marrjen e cilësimit përkatës në mënyrë manuale në ekranin e sistemit Infotainment.

## Administrimi i përdoruesit dhe kryerja e cilësimeve

Administrimi i përdoruesit dhe zgjedhja e cilësimeve bëhen kur ndizet kuadri nëpërmjet sistemit të informimit dhe argëtimit në menynë për administrimin e përdoruesit. Këtu mund të identifikohet ose të regjistrohen përdorues të rinj dhe ju mund të hiqni llogaritë e ruajtura të përdoruesit nga memoria e sistemit të Infotainment *Menaxhimi i përdoruesve*.

Hapni menynë për administrimin e përdoruesit:

1. Prekni në menynë kryesore User (Përdoruesi).

Hapni menynë e cilësimeve:

1. Në menynë për administrimin e përdoruesit prekni Setup.

## Ndryshimi i llogarisë së përdoruesit

Ju mund ta zgjidhni llogarinë e përdoruesit nëpërmjet menysë për administrimin e përdoruesit. Këtu ju mund të aktivizoni në automjet një llogari tjetër ekzistuese të përdoruesit, të hyni në një llogari ekzistuese të përdoruesit We Connect ose të regjistroheni me një llogari të re të përdoruesit te We Connect.

## Caktimi automatik i çelësit të automjetit te një llogari e përdoruesit

Nëse zgjidhet **Automatically (Automatikisht)** caktimi i çelësit, atëherë gjatë ndryshimit të llogarisë së përdoruesit, çelësi i mëposhtëm i automjetit i caktohet llogarisë së përdoruesit:

— *Automjetet pa Keyless Access:* Çelësi i automjetit me të cilin është hapur automjeti.

— *Automjetet me Keyless Access:* Çelësi i automjetit, i cili gjatë hapjes së derës së shoferit është identifikuar së pari nga personalizimi.

Nëse caktimi automatik i çelësit çaktivizohet, atëherë edhe caktimi i çelësit të automjetit fshihet. Gjatë aktivizimit të sistemit Infotainment në automjet shfaqet gjithmonë më pas përdoruesi i fundit aktiv.

## Sinkronizimi i cilësimeve të automjetit

Cilësimet e ndryshuara të automjetit i caktohen automatikisht llogarisë aktive të përdoruesit në automjet dhe ruhen online në mënyrë ciklike. Sinkronizimi i cilësimeve të automjetit me të dhënat e ruajtura online bëhet në mënyrë automatike në situatat e mëposhtme, nëse ekziston një lidhje interneti:

— Në rastin e ndezjes së kuadrit dhe sistemit të Infotainment: sinkronizon të gjitha llogaritë e ruajtura të përdoruesit në automjet që janë përdorur kohët e fundit.

— Gjatë kalimit në një llogari tjetër përdoruesi: sinkronizon llogarinë e sapo aktivizuar të përdoruesit dhe llogarinë e përdoruesit të çaktivizuar tani.

— Në fund të udhëtimit dhe fikjes së kuadrit: sinkronizon llogarinë e fundit aktive të përdoruesit.

Ju mund ta filloni në çdo kohë edhe në mënyrë manuale sinkronizimin në menynë për administrimin e përdoruesit, p.sh. në rast se sinkronizimi automatik ka dështuar gjatë regjistrimit. Sinkronizimi nuk mund të bëhet në mënyrë automatike, nëse është cenuar statusi online i automjetit, p.sh. në garazhet nëntokësore ose nëse keni aktivizuar modalitetin „Privatësia maksimale“.

Nëse një llogari jo aktive e përdoruesit është aktive në një automjet tjetër dhe nga atje sinkronizohen cilësimet, atëherë këto cilësime ngarkohen gjithashtu në automjetin tuaj dhe i caktohen llogarisë së përdoruesit përkatës.

## Cilësimet e personalizueshme të automjetit

Funksionet e rregullueshme të automjetit varen nga pajimi. Disa funksione të personalizueshme nuk ruhen online, por i caktohen llogarisë së përdoruesit në automjet vetëm lokalisht. Funksionet e mëposhtme mund të personalizohen:

— Hap dhe mbyll (hapja e dyerve të veçanta, hapja e komoditetit, dritarja).
— Cilësimet e fshirëseve të xhamave.
— Cilësimet e sediljes.
— Dritat dhe shikimi (dritat e udhëtimit ditën, kohët e ndezjes, dritat e shkurtra, sinjalet komode).
— Cilësimet e sistemit të klimës.
— Sistemet e asistencës aktive të drejtuesit të mjetit.
— Zgjedhja e profilit të drejtimit.
— Treguesi me shumë funksione dhe kruskoti (zgjedhja e treguesve).
— Ekrani Head-up.